



REPUBLIKA E KOSOVËS

**Projekti i Forcimit të Qeverisjes Digjitale për Ofrimin e
Shërbimeve**

(P178162)

**PIANI I PËRGJITHSHËM I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
PLAN (PMMS)**

Versioni Draft

Nentor 2022

Tabela e Përmbajtjes

2	PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL	10
3	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT.....	12
3.1	Objektivat dhe Indikatorët e Zhvillimit të Projektit	12
3.2	Komponentët e Projektit.....	12
4	VENDNDODHJA E AKTIVITETEVE TE PROJEKTIT	18
5	TË DHËNAT BAZË MJEDISORE DHE SOCIALE	19
5.1	Të dhënat Bazë Mjedisore	19
5.1.1	<i>Menaxhimi i Mbetjeve</i>	20
5.2	Të Dhënat Bazë Sociale	22
5.2.1	<i>Grupet e Cënuara/Vulnerabël</i>	23
5.2.2	<i>Ekonomia</i>	24
5.2.3	<i>Arsimi</i>	24
5.2.4	<i>Shërbimi shëndetësor dhe kujdesi shëndetësor</i>	25
5.2.5	<i>Barazia Gjinore</i>	26
5.2.6	<i>Qasja dhe përdorimi i shërbimeve digjitale</i>	26
6	KUADRI I POLITIKËS, LIGJOR DHE RREGULLATOR	28
6.1	Hyrje.....	28
6.2	Politikat specifike të Kosovës, kornizat ligjore dhe administrative të zbatueshme për projektin.....	28
6.2.1	<i>Legjislacioni Mjedisor</i>	28
6.2.2	<i>Menaxhimi i Mbetjeve</i>	30
6.2.3	<i>Legjislacioni për Punën</i>	31
6.2.4	<i>Qeverisja e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit</i>	32
6.3	Politikat dhe Standardet Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore.....	33
6.3.1	<i>Standardet e KMS-së përkatës për projektin</i>	33
6.3.2	<i>Udhëzuesit për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë të Grupit të Bankës Botërore (Udhëzimet MSHS)</i> 35	
7	NDIKIMET POTENCIALE MJEDISORE DHE SOCIALE	37
7.1	Planifikimi/Projektimi.....	37
7.1.1	<i>Shëndeti dhe Siguria në Dizajnin e Projektit</i>	37
7.2	Faza e Ndërtimit.....	38
7.2.1	<i>Rreziqet Mjedisore</i>	38
7.2.2	<i>Rreziqet Sociale</i>	38

7.3	Faza e Operimit	39
7.3.1	<i>Përfitimet Mjedisore</i>	39
7.3.2	<i>Rreziqet Mjedisore</i>	39
7.3.3	<i>Përfitimet Sociale</i>	40
7.3.4	<i>Rreziqet Sociale</i>	41
8	ZBUTJA	43
8.1	Masat zbutëse mjedisore dhe sociale.....	43
9	ZBATIMI.....	50

Lista e Tabelave

Tabela 6-1	Veprimet e kërkuara të Standardeve Mjedisore dhe Sociale të Projektit	33
Tabela 6-2	Vlerësimi i projektit kundrejt Udhëzuesit të MSHS-së për Telekomunikacionin të BB	36
Tabela 8-1	Masat e Propozuara Zbutëse Mjedisore dhe Sociale.....	44

Akronimet dhe Shkurtime

AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
ASHI	Agjencia për Shoqërinë e Informacionit
ARC	Agjencia e Regjistrimit Civil
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
CPF	Korniza e Partneritetit të Vendit
DRC	Qendra e Rimëkëmbjes nga Fatkeqësitë
DVP	Dokumenti i Vlerësimit të Projektit
ESS	Standardi Mjedisor dhe Social
IDA	Shoqata Ndërkombëtare e Zhvillimit
IEK	Informimi, Edukimi dhe Komunikimi
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
KE	Komisioni European
KMM	Kuadri i Menaxhimit Mjedisor
KMS	Kuadri Mjedisor dhe Social
KMP	Komiteti i Menaxhimit të Projektit
LMB	Leje Mjedisore Bashkiake
MIST	Ministria e Industrisë, Sipërmarrjes dhe Tregtisë
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MNK	Mbeturinat e Ngurta Komunale
MOP	Manuali Operacional i Projektit
MPEE	Mbetjet nga Pajisjet Elektrike dhe Elektronike
MZA	Mekanizmi i Zgjidhjes të Ankesave
NJZP	Njësia e Zbatimit të Projektit
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OJQ	Organizata Joqeveritare
OZHP	Objektivi i Zhvillimit të Projektit
PAK	Personat me Aftësi të Kufizuara
PAMS	Plani i Angazhimit Mjedisor dhe Social
PAPI	Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PMMS	Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social
PMP	Procedura e Menaxhimit të Punës
PHQ	Partneritet i Hapur Qeveritar
PPM	Pajisje Personale Mbrojtëse
QDHS	Qendra e të dhënave shtetërore
QK	Qeveria e Kosovës
QSHI	Qendra e Shërbimit të Integruar
SCD	Diagnostikimi sistematik i vendit
SHAS/NS	Shfrytëzimi, Abuzimi Seksual/Ngacmimi Seksual
SHSP	Shëndeti dhe Siguria në Punë
TKP	Treguesit kryesorë të performancës
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
UA	Udhëzim Administrativ
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Projekti i Kosovës për Forcimin e Qeverisjes Digjitale është një operacion investimi pesëvjeçar i financuar nga Banka Botërore - Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) dhe do të zbatohet nga Agjencia për Shoqërinë e Informacionit (ASHI) nën Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB). Objektivi i zhvillimit të projektit është të përmirësojë cilësinë dhe aksesin e përdoruesve në shërbimet e përzgjedhura administrative publike, duke reflektuar në këtë mënyrë objektivat e Programit të Qeverisë 2021-2025 dhe punën e tij të vazhdueshme për zhvillimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të qeverisjes digjitale. Projekti i propozuar pritet të mbështesë Fushën 2 të Fokusit të Kornizës të Partneritetit të Vendit (CPF) të Republikës të Kosovës për periudhën 2017-2021 – *Forcimi i Ofrimit të Shërbimeve Publike dhe Menaxhimit Makro Fiskal*. Projekti do të kontribuojë gjithashtu në:

- zhvillimin e proceseve dhe infrastrukturës thelbësore të ofrimit të shërbimeve qeveritare që do të mbështesin kapacitetin e Kosovës për përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike përmes tranzicionit drejt zgjidhjeve të ruajtjes në cloud, forcimit të qendrës së rimëkëmbjes nga fatkeqësitë (DRC) dhe digjitalizimit të shërbimeve
- financimin e investimeve për transformimin digjital të operacioneve të brendshme të qeverisë dhe në rrjedhën e ofrimit të shërbimeve publike që synojnë përmirësimin e aksesit të përgjithshëm të qytetarëve në shërbime dhe ndërveprimin e tyre me qeverinë
- përfshirjen e mekanizmave të caktuar me bazë gjinore në hartimin e mënyrave të angazhimit qytetar
- angazhimin e mjeteve të ngjashme CivicTech, si dhe qasjen në disa kanale të ofrimit të shërbimeve për të rritur ndërgjegjësimin, për të rritur aftësitë digjitale dhe për të përmirësuar aksesin në shërbimet publike digjitale që kanë më shumë nevojë për këto komunitete.

Projekti i propozuar pritet gjithashtu të mbështesë rimëkëmbjen e Kosovës nga pandemia e COVID-19 në periudha afatmesme dhe afatgjatë, dhe kontribuon në *Shtyllën 4 të Kuadrit Global të Reagimit ndaj Krizave të BB-së: Forcimi i politikave, institucioneve dhe investimeve për rinvendosje më të mire*.

Ky Plan i Përgjithshëm i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) do të sigurojë një analizë të ndikimeve mjedisore dhe sociale të lidhura me aktivitetet e projektit dhe do të identifikojë masat e duhura zbutëse në përputhje me Kornizën Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore dhe Standardet përkatëse Mjedisore dhe Sociale (ESS) të saj. Shqyrtimi mjedisor dhe social në Fazën e Konceptit të Përmbledhjes së Rishikimit Mjedisor dhe Social identifikoi ESS-të e mëposhtme si të rëndësishme:

- ESS1 Vlerësimi dhe Menaxhimi i Rreziqeve dhe Ndikimeve Mjedisore dhe Sociale
- ESS2 Puna dhe Kushtet e Punësimit
- ESS3 Efikasiteti i Burimeve dhe Parandalimi dhe Menaxhimi i Ndotjes
- ESS4 Shëndeti dhe Siguria e Komunitetit
- ESS10 Angazhimi i Palëve të Interesuara dhe Bërja Publike e Informacionit

PMMS-ja do të finalizohet gjatë zbatimit të projektit në përfundim të dizajnit dhe para fillimit të procesit të prokurimit për punët civile.

Rreziqet Mjedisore dhe Sociale dhe Menaxhimi

Shqyrtimi fillestar mjedisor dhe social nuk identifikoi gjasa për ndonjë rrezik dhe/ose ndikim të pakthyeshëm. Ndikimet e mundshme janë të vogla, kryesisht specifike për vendin ku do të realizohet Projekti dhe të kthyeshme; dhe mund të menaxhohen në mënyrë efektive përmes strategjive të zbutjes të përshkruara në këtë PMMS. Rreziqet e projektit klasifikohen si **Mesatare**.

Më poshtë paraqiten të përmbledhura rreziqet kryesore mjedisore dhe sociale, së bashku me masat e propozuara zbutëse dhe sipas ESS-ve të aplikuara për aktivitetet e konsideruara:

Puna dhe Kushtet e Punësimit - rreziqet e përgjithshme të punës pritet të jenë të ulëta dhe të menaxhueshme. Propabiliteti i rreziqet që lidhen me rastet e punës së fëmijëve ose punës së detyruar dhe rreziqet SHAS/NS janë minimale/të papërfillshme dhe menaxhohen nëpërmjet legjislacionit kombëtar dhe dispozitave të përfshira në PMP. Për më tepër, ata punëdhënës të kontraktuar për instalimin e hardware-ve dhe pajisjeve kritike në DRC, për nevoja rinovimi dhe investime shtesë në hardware dhe software, për Qendrën e Kontaktit dhe Qendrën e Shërbimit të Integruar (QSHI) përballen me nivele të ulëta të rrezikut nga punimet elektrike dhe rreziqe të SHSP-së. Nuk priten rreziqe të konsiderueshme nga zjarri gjatë zbatimit dhe funksionimit të qendrës së rikuperimit nga fatkeqësitë. Megjithatë, të gjithë punëtorët do të punësohen në përputhje me dispozitat e Procedurës të Menaxhimit të Punës (PMP). Të dhëna të dokumentuara në lidhje me kushtet e punës të firmave të konsulencës që do të kontraktohen për aktivitetet në kuadër të projektit do të pasqyrohen në MOP, PMP, dokumentet e tenderit dhe kontratat aktuale midis NjZP-së dhe ofruesve të saj. Të gjithë kategoritë e punonjësve mund të përfshihen në aktivitete që ngrenë shqetësime për ekspozimin ndaj COVID-19. Për të zbutur rrezikun, projekti në përgjithësi do të ndjekë udhëzimet kombëtare të zbatueshme dhe udhëzimet e OBSH-së, si dhe politikat përkatëse të Bankës.

Eficienca e Burimeve dhe Parandalimi dhe Menaxhimi i dhe Ndotjes - Rreziqet e pafavorshme mjedisore si pluhuri, ndotja e ajrit, gjenerimi i mbeturinave, për shkak të rinovimit tipik të zyrave do të adresohen duke zbatuar masat e specifikuar në këtë PMMS të përgjithshëm. Ndikimet indirekte që lidhen me sasinë e shtuar të mbetjeve elektronike, rritjen e përdorimit të energjisë nga përdorimi i gjeneratorëve rezervë të energjisë dhe përdorimi i sistemeve të ftohjes dhe shuarjes së zjarrit do të adresohen përmes aplikimit të procedurave dhe masave të përshtatshme për menaxhimin e mbetjeve elektronike, për përdorimin efikas të burimeve, të përfshira në këtë PMMS. Mbetjet elektronike të gjeneruara në kuadër të Projektit do të menaxhohen sipas sistemit kombëtar ekzistues të përpunimit të mbetjeve dhe do të eksportohen për riciklim.

Shëndeti dhe Siguria e Komunitetit – ekziston një rrezik i ulët për shëndetin dhe sigurinë e komunitetit, veçanërisht për popullatat e cënuara/vulnerabël¹, i lidhur me menaxhimin jo të duhur të mbetjeve elektronike. Kjo do të menaxhohet duke përfshirë dispozita për menaxhimin e përshtatshëm të mbeturinave/mbetjeve elektronike, duke përfshirë menaxhimin e aksesit/rrethimit të venddepozitimeve. Çështjet që kanë të bëjnë me krimin kibernetik, humbjen/shpërdorimin e të dhënave do të menaxhohen sipas dispozitave të legjislacionit të Kosovës për menaxhimin e duhur.

Angazhimi i Palëve të Interesuara dhe Berja Publike e Informacionit - kërkesat për të siguruar identifikimin në kohë dhe të saktë të palëve të interesuara dhe një qasje sistematike për angazhimin e palëve të interesuara, do të ndërmerren në përputhje me Planin e Angazhimit të Palëve të Interesit (PAPI) të përgatitur për Projektin.

Njësia e Zbatimit të Projektit (NjZP) do të jetë përgjegjëse për të siguruar që kjo PMMS e përgjithshme të jetë e integruar plotësisht gjatë gjithë zbatimit. PMMS-ja do të jetë pjesë e çdo dokumenti të ofertës, TeR-ve ose

¹ Romët dhe të varfërit) të angazhuar në grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme (plastikë, metale, letër dhe karton, bateri dhe MPEE, etj.) dhe për disa punonjës të kompanise nga shërbimet formale të grumbullimit të cilët ka mundësi të jenë gjithashtu të përfshirë në këto aktivitete

marrëveshjeve kontraktuale për punimet e rinovimit, pajisjet dhe instalimet e hardware-ve. PMMS-ja do të integrohet plotësisht në Projekt për të siguruar që të gjitha masat e kërkuara janë plotësisht të kuptueshme dhe të respektohen nga të gjitha palët përgjegjëse me qëllim zbatimin e suksesshëm të projektit.

1 HYRJE

1.1 Konteksti i Projektit

Që nga miratimi i Strategjisë së parë në vend të Qeverisjes Elektronike (2009-2015), gjatë dekadës së fundit QK-ja ka ndërmarrë veprime për të mbështetur rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve publike duke i dhënë përparësi reformave të administratës publike për të transformuar sektorin e saj publik në një sektor më modern, për administrim efikas dhe me në qendër qytetarin dhe duke mbështetur zhvillimin e një qasjeje GovTech për ofrimin e shërbimeve. QK-ja ka bërë përparime të rëndësishme në zgjerimin e lidhjes me brez të gjerë (broadband) me mbështetjen e Projektit të Ekonomisë Digjitale të Kosovës (KODE). Megjithatë, përkundër nivelit të lartë të lidhjes me internet në Kosovë, rezultatet e anketimit tregojnë për përdorim të kufizuar të shërbimeve online të ofruara nga institucionet qeveritare dhe pakënaqësi me ofrimin e shërbimeve.

Ndërsa zhvillimet e deritanishme paraqesin disa përparime të rëndësishme në aspektin e reformës digjitale, Kosova ende përballlet me një numër sfidash në zhvillimin e shërbimeve digjitale, me implikime për cilësinë dhe aksesin e shërbimeve. Një arsye kryesore për aksesin e pabarabartë dhe cilësinë e dobët të shërbimeve, pavarësisht përmirësimeve në lidhjen digjitale, ka qenë qasja pjesë-pjesë e digjitalizimit, e cila ka rezultuar në fragmentimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Ndërveprueshmëria dhe Portali i Shërbimit Shtetëror janë gjithashtu në një fazë të hershme zhvillimi. Progresi për sigurimin që portali eKosova të bëhet dritarja kryesore për ofrimin e shërbimeve publike ka qenë i ngadaltë. Aty ku shërbimet janë të disponueshme online, shumica ofrohen përmes portaleve të agjencive individuale, duke e bërë të vështirë transferimin e të dhënave midis agjencive dhe duke bërë që ofrimi i shërbimeve të organizohet rreth strukturës administrative përgjegjëse. Qeveria e Kosovës (QK) nuk ka infrastrukturën thelbësore të TIK-ut të një platforme intranet ose digjitale për Sistemin qeverisës për të komunikuar në mënyrë efektive me punonjësit e saj ose një vend ku punonjësit publik mund të lidhen, të ndajnë informacione dhe të bashkëpunojnë. Vendit i mungon një organ i dedikuar për qeverisjen e të dhënave dhe ekziston nevoja për të zhvilluar standarde dhe protokolle kombëtare të ndërveprimit në përputhje me Strategjinë e re të Qeverisjes Elektronike 2023-2027 dhe Kornizën e re Evropiane të Ndërveprueshmërisë të Komisionit Evropian. Për më tepër, Qeveria ende nuk ka krijuar një njësi përgjegjëse për lëshimin e certifikatave digjitale, vendimtare për zbatimin e ligjeve për nënshkrimin elektronik.

Për të adresuar këto sfida, QK-ja synon të zhvillojë Projektin e “Forcimit të Qeverisjes Digjitale për Ofrimin e Shërbimeve”. QK-ja pranon se digjitalizimi i suksesshëm i shërbimeve përbën një implikim të rëndësishëm për përpjekjet e qeverisë për të luftuar korrupsionin dhe është një element i rëndësishëm të përpjekjeve të vendit për t’iu përshtatur ndryshimeve klimatike. Projektin e propozuar pritet të mbështesë Fushën e Fokusit 2 të CPF-së për Republikën e Kosovës për periudhën 17-21 – *Forcimi i Ofrimit të Shërbimeve Publike dhe Menaxhimit Makro Fiskal*. Ai gjithashtu synon të adresojë fushat kyçe të Diagnostifikimit Sistemik të Vendit 2021 (SCD).

Projektin do të financojë kryesisht investimet për transformimin digjital të operacioneve të brendshme të qeverisë dhe për rrjedhën e ofrimit të shërbimeve publike që synojnë përmirësimin e aksesit universal të qytetarëve në shërbime dhe ndërveprimin e tyre me Qeverinë. Dizajni i projektit i jep prioritet shërbimeve publike duke njohur nevojën për t’i bërë ato shërbime më të barabarta, me shërbime digjitale që synohen veçanërisht për të përmirësuar aksesin për grupet e cënueshme sociale (d.m.th., të varfërit, gratë, romët, etj). Ai do të përfshijë mekanizma të caktuar me bazë gjinore në dizajnin e mekanizmave të angazhimit qytetar dhe do të angazhojë mjete të ngjashme CivicTech, si dhe disa kanale për qasje në shërbimet e ofruara për të rritur ndërgjegjësimin, për të rritur aftësitë digjitale dhe për të përmirësuar aksesin ndaj shërbimeve publike digjitale, për të cilat kanë më shumë nevojë këto komunitete.

Agjencia e zbatimit të Projektit është Agjencia për Shoqërinë e Informacionit. Palë të tjera kryesore të interesuara janë; Ministria e Punëve të Brendshme (MPB); Zyra e Kryeministrit, Ministria e Industrisë, Sipërmarrjes dhe Tregtisë (MIET) dhe ministritë dhe agjencitë e tjera.

2 PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

Dokumenti i Planit të Përgjithshëm të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) (ky dokument) vlerëson rreziqet mjedisore dhe sociale të Projektit, ofron një analizë të ndikimeve të Projektit dhe identifikon masat e duhura zbutëse, duke përfshirë edhe përgjegjësitë për zbatimin. Metodologjia për përgatitjen e këtij PMMS përfshin; rishikimin në zyrë bazuar në informacionin dytësor, gjetjet nga projekti i mëparshëm për Digjitalizimin e Kosovës (Projekti KODE) dhe dokumente të tjera të Bankës Botërore dhe konsultimet me palët kryesore të interesuara. Plani i Angazhimit Mjedisor dhe Social (PAMS) është referuar në marrëveshjen ligjore ndërmjet Bankës dhe Qeverisë së Kosovës dhe përcakton veprimet dhe përgjegjësitë kryesore për zbatimin e projektit.

2.1 Qëllimi dhe Fushëveprimi i PMMS

Sipas Kornizës Mjedisore dhe Sociale të BB-së (KMS), një vlerësim mjedisor dhe social duhet të kryhet për të vlerësuar rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale të projektit gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit. Vlerësimi duhet të jetë proporcional me rreziqet dhe ndikimet e projektit dhe të adresojë të gjitha rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale të drejtpërdrejta, të tërthorta dhe kumulative gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit. Vlerësimi Mjedisor dhe Social duhet të adresojë kërkesat e Standardeve Mjedisore dhe Sociale (ESS) për të arritur rezultate mjedisore dhe sociale në përputhje me ato të përshkruara në KMS.

Shqyrtimi fillestar i rrezikut mjedisor dhe social tregoi se Projekti ka një shkallë Mesatare të rrezikut mjedisor dhe social. Aktivitetet e projektit nuk pritet të kenë ndikime të pakthyeshme mjedisore, por kryesisht ndikime mjedisore afatshkurtra, lokale dhe të kthyeshme që ka të ngjarë të hasen dhe përfshijnë shqetësime tipike të lidhura me rinovimin, si pluhuri, ndotja e ajrit, gjenerimi i mbeturinave dhe rreziqe të shëndetit dhe sigurisë, etj. Në këndvështrimin social, projekti vlerësohet si me rrezik të ulët për shkak të ndikimeve të mundshme negative që mund të ketë digjitalizimi i shërbimeve, dhe që lidhen me përjashtimin e grupeve të cënuara/vulnerabël si të moshuarit, të varfërit dhe romët (të cilët kanë akses të kufizuar në shërbimet e TI-së); çdo rrezik që lidhet me humbjen e të dhënave dhe/ose keqpërdorimin e të dhënave për shkak të procesit të digjitalizimit; ndikimet që lidhen me kushtet e punës (shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve) dhe rreziqet e SHAS/NS; dhe rreziqet e shëndetit dhe sigurisë së komunitetit (veçanërisht popullsia e cënueshme) në rast të mosmenaxhimit të duhur të mbetjeve elektronike.

Për më tepër, nuk do të kërkohet asnjë përvetësim i pavullnetshëm i tokës ose zhvendosje fizike tek banorët zyrtarë ose joformalë pasi aktivitetet për instalimin e hardware-ve dhe pajisjeve kritike në DRC do të kryhen në objektet ekzistuese të pashfrytëzuara, dhe nevojat për mobilim dhe rinovim dhe investime shtesë në hardware dhe software, për Qendrën e Kontaktit dhe QSHI në Prishtinë do të mbështeten në vendodhje ekzistuese të qeverisë.

Në këtë kontekst, ky PMMS i përgjithshëm përcakton masat zbutëse, monitorimin dhe përgjegjësitë institucionale të nevojshme për të eliminuar, kompensuar ose reduktuar ndikimet negative mjedisore dhe sociale në nivele të pranueshme në përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse të Kosovës, Kornizën Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore, dhe praktikat më të mira.

2.2 Integrimi i PMMS-së

Njësia e Zbatimit të Projektit (NjZP) është përgjegjëse për të garantuar që ky PMMS i përgjithshëm të integrohet plotësisht gjatë zbatimit të projektit. PMMS-ja do të jetë pjesë e çdo dokumentacioni të ofertës, TeR-ve ose marrëveshjes së partneritetit për punët fizike dhe është përgjegjësi e NjZP-së të sigurojë që të gjitha dokumentet e prokurimit, marrëveshjet e partneritetit dhe specifikimet kontraktuale i nënshtrohen shqyrtimit në kuadër të këtij PMMS-je dhe kërkesave në dokumentin e Rregullores të Prokurimit për Huamarrësit e IPF-së: Mallrat,

Punët, Shërbimet Jo-Konsulente dhe Shërbimet e Konsulencës datë 1 korrik 2016, rishikimi i fundit Nëntor 2020. PMMS-ja do të përdoret gjithashtu për menaxhimin e rrezikut të aspekteve sociale të projektit.

2.3 Publikimi

PMMS-ja duhet të bëhet publike nga ASHI si agjencia përgjegjëse për zbatimin e projektit. Një njoftim publik përmes gazetës/radios dhe/ose postimit në media sociale në faqen web të ASHI-it në Facebook dhe në faqen web të Zyrës së Kryeministrit (derisa website i ASHI të jetë i disponueshëm) do të njoftojë publikun për publikimin e instrumenteve. Po kështu, ASHI do të sigurojë që disa kopje të të gjitha instrumenteve të përgatitura për menaxhimin e rreziqeve M&S të jenë të disponueshme në nivel lokal në zyrën e ASHI dhe lehtësisht të aksesueshme për grupet e prekura dhe Organizatat Joqeveritare (OJQ-të) lokale. PMMS-ja do të rishikohet pasi të jenë përfunduar dizajnet e aktiviteteve të detajuara dhe pasi ato të finalizohen dhe rimiratohen nga Qeveria e Kosovës dhe Banka Botërore para fillimit të procesit të tenderimit për ndonjë punë fizike. Për secilin version të përditësuar të miratuar të këtij PMMS-je, NjZP-ja do të jetë përgjegjëse për publikimin përmes kanaleve të mësipërme.

3 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

3.1 Objektivat dhe Indikatorët e Zhvillimit të Projektit

Objektivi i Zhvillimit të Projektit (OZHP) të propozuar është të përmirësojë cilësinë dhe qasjen e përdoruesve në shërbimet e përzgjedhura administrative publike në Kosovë, duke reflektuar në këtë mënyrë objektivat e Programit të Qeverisë 2021-2025 dhe punën e vazhduar për zhvillimin e Strategjisë gjithëpërfshirëse të Qeverisjes Elektronike 2023-2027.

Progresi i projektit do të matet kundrejt treguesve të mëposhtëm të rezultateve të OZHP-së:

- Numri i transaksioneve të kryera përmes portalit e-Kosova për muaj (ne aspektin e qasjes/aksesit)
- Përqindja e grave që aksesojnë shërbimet publike përmes e-Kosovës (ne aspektin e qasjes/aksesit)
- Përqindja e grupeve të cenueshme të synuara që kanë qasje në shërbimet publike përmes e-Kosova (d.m.th., të varfërit, Komuniteti Rom/Ashakli/Egjiptian, individët me aftësi të kufizuara) (ne aspektin e qasjes/aksesit)
- Përputhshmëria me "standartet e shërbimit" për shërbimet sipas kategorive të ngjarjeve pilot të jetës (ne aspektin e cilësisë)
- Numri i shërbimeve të web-it që automatizojnë shkëmbimin e sigurt dhe të besueshëm të të dhënave nëpërmjet Portës së Qeverisë (GG) (ose mjetit lëvizës të Shërbimit të Qeverisë) (në aspektin e cilësisë)

3.2 Komponentët e Projektit

Financimi i projektit do t'i japë përparësi investimeve në infrastrukturën TIK plus asistencën teknike të kërkuar për ofrimin e rezultateve të identifikuara nëpërmjet tre komponentëve të ndërlidhur, të strukturuar si më poshtë;

- **Komponenti 1: Transformimi digjital i qeverisë**

Ky komponent do të mbështesë iniciativat për të krijuar arkitekturën e "krejt qeverisë"² dhe platformat e përbashkëta të nevojshme për transformimin digjital të qeverisë dhe lehtësimin e ofrimit të shërbimeve publike me në qendër qytetarin. Kjo përfshin përmirësimin e ndërveprimit të sistemeve qeveritare, zgjidhjet për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë/vazhdimësinë e biznesit dhe platformat e përbashkëta (p.sh., Porta e Qeverisë, arranzhimet e Qendres të Dhenave Shtetërore/Qendres të Rimekembjes ndaj Fatkeqesive (QDHS/DRC), platforma tërësore e qeverisë). Në veçanti, komponenti do të mbështesë fushat e mëposhtme:

Nën-komponenti 1.1: Zhvillimi i standardeve dhe protokolleve të ndërveprimit dhe infrastrukturës së përshtatshme

Ky nënkomponent synon të forcojë bazat për ofrimin e shërbimeve digjitale nëpërmjet zhvillimit të standardeve të ndërveprueshmërisë dhe infrastrukturës së përshtatshme shoqëruese. Ai do të përfshijë:

- (i) Zhvillimin dhe zbatimin e një Kornizë Kombëtare të Ndërveprueshmërisë në përputhje me Kornizën e re Evropiane të Ndërveprueshmërisë (EIF);
- (ii) përmirësimin e Portalit Kombëtar të të

² Qasja e tërësisë së qeverisë vë theksin në integrimin në lidhje me aktivitetet, planet dhe platformat e përbashkëta midis njësive qeveritare në vend të fragmentimit dhe burokratizmit. GovTech parashikon një qasje të plotë të qeverisë me sisteme qeveritare të ndërveprueshme, zgjidhje të shërbimeve elektronike pa probleme dhe qendra të shërbimit për qytetarët që ofrojnë akses në të gjitha shërbimet publike dhe nxitjen e një qeverisje lehtësisht të aksesueshme, efikase dhe transparente me qytetarët në qendër të reformave.

Dhënave të Hapura³ përmes zhvillimit të proceseve për të mundësuar përditësime më të shpeshta dhe cilësime shtesë të Ndërfaqes së Programimit të Aplikimit (NPA), (iii) vlerësimin dhe përmirësimin e Portës Qeveritare (GG) për të automatizuar shkëmbimin e sigurt të të dhënave për sistemet kyç qeveritare si dhe shërbimet G2G dhe G2C/G2B të ofruara përmes portalit e-Kosova, dhe për zgjerimin e përdorimit të tij, duke përfshirë hardware me efikasitet të energjisë sipas nevojës; (iv) përmirësime në ndërveprimin e regjistrave bazë dhe njësive kryesore publike të përzgjedhura; dhe (v) ndërtimin e kapaciteteve dhe aktivitetet e menaxhimit të ndryshimit.

Nën-komponenti 1.2: Forcimi i marrëveshjeve/proceseve QDHS/DRC dhe tranzicioni drejt një platforme qeveritare cloud.

Objektivi i këtij nënkomponenti është të forcojë marrëveshjet/proceset e qendrës së të dhënave shtetërore (QDHS) dhe qendrës së rikuperimit nga fatkeqësitë (DRC) dhe të mbështesë kalimin në teknologjinë cloud, në mënyrë që të rrisë qëndrueshmërinë e operacioneve të biznesit të qeverisë ndaj ndërprerjeve ndër të tjera, nga fatkeqësitë natyrore të ndryshimeve klimatike dhe ngjarjet e tjera, në Kosovë. Ai do të përfshijë:

- (i) Mbështetje për krijimin e një DRC-je të përbashkët për nevoja afatshkurtra për të hostuar sisteme të zgjedhura të informacionit kritik të qeverisë që kërkojnë pothuajse zero ndërprerje ose humbje të të dhënave në rast të ndërprerjeve në qendrën e të dhënave; (ii) zhvillimi i një Plani të Tranzicionit në Cloud Computing që do të ofrojë një udhërrëfyes për kalimin në një platformë qeveritare cloud hibride, që përveç sigurimit të sigurisë dhe bartjes të informacionit dhe do të sigurojë edhe konfidencialitetin e sistemeve të informacionit dhe të të dhënave, integritet dhe disponueshmëri; një plan migrimi për sektorin publik; dhe mbështetje për përgatitjen e politikave shoqëruese që synojnë sigurimin e gatishmërisë së cloud dhe njohjen për cloud të të gjitha sistemeve të reja të informacionit; dhe (iii) blerja e pajisjeve kritike me efikasitet energjetik për QDHS/DRC, sipas nevojës, për të mbrojtur informacionin e ruajtur dhe mbajtur në regjistrat e qeverisë.

Nën-komponenti 1.3: Zhvillimi i një platforme “gjithëpërfshirëse qeveritare”.

Objektivi i këtij nënkomponenti është të zhvillojë një platformë gjithëpërfshirëse qeveritare që do të shërbejë si një qendër efikase për nëpunësit publikë dhe do të përmirësojë proceset e brendshme, komunikimin dhe bashkëpunimin. Ai do të përfshijë:

- a) Projektimin, zhvillimin dhe vendosjen graduale të një platforme gjithëpërfshirëse qeveritare që synon përmirësimin e komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndërmjet nëpunësve publikë, si dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit 2030 dhe politikave të tjera të qeverisë, duke përfshirë ndër të tjera, fushat funksionale që lidhen me organizimin dhe burimet njerëzore, bashkëpunimin, menaxhimin e burimeve, njoftimet, menaxhimin e rrjedhës së punës/rastit (përfshirë lidhjet me sistemin e menaxhimit të dokumenteve dhe instrumentat kombëtare të nënshkrimit elektronik), arkivimin elektronik dhe instrumentat e monitorimit dhe menaxhimit të performancës; si dhe aktivitetet që lidhen me ndërtimin e kapaciteteve dhe administrimin e ndryshimit.
- b) Vlerësimin e nevojave për infrastrukturën e rrjetit qeveritar (GovNet) dhe mbështetje për zgjerimin e infrastrukturës së GovNet-it, duke përfshirë pajisjet me efikasitet energjetik sipas nevojës.

• Komponenti 2: Transformimi digjital i ofrimit të shërbimeve publike

Ky komponent do të mbështesë zgjerimin e shërbimeve elektronike të qeverisë përmes përmirësimeve të platformës e-Kosova dhe do të pilotojë një qasje inovative për ofrimin proaktiv të shërbimeve me në qendër qytetarin dhe të organizuar rreth ngjarjeve të jetës (life event). Paralelisht me mbështetjen e përmirësimeve në platformën e-Kosova dhe një numri të zgjeruar të shërbimeve në dispozicion, Projekti do të mbështesë

³[Open Data Republic of Kosovo](#)

aktivitetet që ndihmojnë Kosovën për tranzicion drejt shërbimeve me në qendër qytetarin përmes adoptimit të një qasjeje me disa kanale për ofrimin e shërbimeve dhe avancimit të një qasjeje inovative nëpërmjet grupimit të shërbimeve rreth ngjarjeve jetësore për t'u angazhuar në mënyrë proaktive me qytetarët/përdoruesit. Mbështetja e projektit do të strukturohet rreth katër nën-komponentëve.

Nën-komponenti 2.1. Përmirësimi dhe përditësimi i platformës e-Kosova dhe regjistrave bazë

Objektivi i këtij nën-komponenti është të mbështesë zgjerimin e shërbimeve digjitale qeveritare në një portal të përditësuar e-Kosova dhe të mbështesë ndërlihdjen e regjistrave bazë, veçanërisht të regjistrat civil. Në veçanti, ai do të përfshijë:

- (a) Përmirësime teknike në platformën e-Kosova që përmirësojnë disponueshmërinë, ndryshimin në shkallë apo madhësi, performancën, sigurinë dhe aksesueshmërinë, dhe përfshirjen e shërbimeve tashmë të disponueshme si e-shërbime ose në proces të digjitalizimit⁴.
- (b) Përmirësimet në akses përmes një dizajni të përditësuar të aplikacionit e-Kosova për të përmirësuar ndërfaqen e përdoruesit, përfshirë edhe për përdoruesit me nevoja të veçanta, duke përmbushur standardet WCAG 2.0 ose standarde më të reja për individët me aftësi të kufizuara; dhe zhvillimin e një aplikacioni celular të përmirësuar te e-Kosova;
- (c) Ndërlidhjen e mëtejshme të regjistrave bazë kryesorë, veçanërisht të databazës të të dhënave të Agjencisë së Regjistrimit Civil të Kosovës (ARC) me e-Kosova dhe përdorimin nga organizata të tjera për të promovuar shërbimet e integruara, ndër të tjera edhe përmes: (i) krijimit të një arkivi elektronik të dosjeve të të gjitha dokumentet kryesore individuale të identifikimit të lëshuara në Kosovë gjatë ish-Jugosllavisë dhe më vonë gjatë pushtimit të Kosovës që do të mundësojnë lidhje me regjistrat e tjerë përkatës të ARC-së dhe ndërlihdjen me regjistrat e tjerë bazë, bazat e të dhënave; (ii) zhvillimit të një platforme të centralizuar, platforme elektronike të të dhënave të hapura për ARC-në për të ndihmuar organizatat dhe qytetarët e tjerë të interesuar të lidhen me të dhënat e përditësuara, në kohë reale nga sistemi i ARC-së; (iii) avancimit dhe mirëmbajtjes të sistemit të patentave; (d) mbështetjes për ndërlihdjen e bazave të të dhënave të ARC-së dhe sistemeve të tjera elektronike të qeverisë; dhe (e) blerjen e pajisjeve me efikasitet energjie sipas nevojës.
- (d) Forcimi i grupeve të dedikuara të punës të ASHI-it që janë përgjegjës për menaxhimin e platformës e-Kosova, si dhe një fokus i shtuar në analitikën e të dhënave dhe hulumtimin e përdoruesve, duke përfshirë përcaktimin e treguesve kyç të performancës (TKP) dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit (MNSH) për çdo shërbim të përzgjedhur që aksesohet në e-Kosova, zhvillimin e një paneli kontrolli të performancës, raporte të monitorimit dhe rekomandime për përmirësimin e cilësisë bazuar në informacionin e gjeneruar.

Nën-komponenti 2.2. Rritja e Aksesit në disa Kanale për Shërbimet Digjitale me Qendër Qytetarin

Objektivi i këtij nënkomponenti është të vërë në funksion aksesin në disa kanale për shërbimet, duke përfshirë një fushatë komunikimi për të mobilizuar qytetarët si përdorues të shërbimeve dhe një arkitekturë të modernizuar të shërbimit ndaj klientit. Në veçanti, ai do të përfshijë:

- (a) Projektimin dhe përmirësimin e një Qendre të re Kontakti të e-Kosovës, të digjitalizuar në ASHI dhe me disa kanale, duke përfshirë, ndër të tjera: (i) zhvillimin e software-it të integruar të linjës së ndihmës, i cili është i lidhur me e-Kosova dhe sisteme të tjera përkatëse; (ii) vendosjen e software-it të menaxhimit

⁴ Megjithëse fokusi kryesor i projektit për digjitalizimin e shërbimeve do të ishte në kategoritë e identifikuar të ngjarjeve jetësore sipas nënkomponentit 2.3, nëse është e mundur, projekti do të mbështesë gjithashtu përmirësimet e nevojshme në software për shërbimet që janë në proces të digjitalizimit ose të disponueshme si shërbime elektronike që të bëhen të disponueshme në platformën e-Kosova. Për shembull, shërbimet e prokurimit elektronik me agjencinë kombëtare të prokurimit, shërbimet e planifikuara në lidhje me gjyqësorin, licencat dhe lejet e ofruara nga Ministria e Mjedisit dhe shërbimet nga Ministria e Bujqësisë, në shtese të shërbimeve të pakta (informacione dhe grante) tashmë në e-Kosova

të marrëdhënieve me klientët (CRM) për të mbështetur zgjidhjen e problemeve të përdorimit të shërbimit digjital, duke përfshirë menaxhimin e biletave, monitorimin në kohë reale, një asistent virtual me tekst dhe zë për të filtruar pyetjet e shërbimit nga përdoruesit; dhe mbledhjen e reagimeve të përdoruesve përmes mesazheve me tekst; (iii) blerjen e pajisjeve të duhura me efikasitet energjetik dhe pajisjeve të rrjetit, si dhe mobilimin e nevojshëm për Qendrën e Kontaktit e-Kosova; (iv) analizën e të dhënave të përdoruesve, duke përfshirë të dhënat e bazuara në anketimet e reja për përdoruesit individualë që kanë akses në një shërbim elektronik; dhe (v) nevojat shtesë të identifikuar për trajnim të fuqisë punëtore në Qendrën e Kontaktit.

- (b) Krijimin e një qendre pilot të shërbimeve të integruara (QSHI) në Prishtinë, në një vendodhje ekzistuese qeveritare, duke përfshirë, ndër të tjera, (i) financimin për një studim fizibiliteti dhe një konkurs për projektin dhe masterplanin e zonës; (ii) mbështetjen për nevojat e vogla për rinovim dhe investime shtesë në hardware dhe software me efikasitet energjie për ta bërë QSHI-në e re funksionale dhe për të maksimizuar efikasitetin e energjisë; dhe (iii) një fushatë komunikimi për të rritur ndërgjegjësimin për QSHI-në e Prishtinës, dhe e lidhur me aktivitetin 2.2(c).
- (c) Zhvillimin dhe shpërndarjen e një fushate aktive informimi, edukimi dhe komunikimi (IEK) për të rritur ndërgjegjësimin dhe mobilizimin e qytetarëve në kanalet e shumta të aksesit të shërbimeve elektronike, duke përfshirë, ndër të tjera, (i) një anketim në vitin e parë që synon grupet e cenuara/vulnerabel (të moshuarit, gratë, komunitetet RAE) për të hartuar më mirë programin e IEK-së; (ii) anketime shtesë të hartuara dhe zbatuara në periudhën afatmesme të projektit dhe më pas gjatë viteve (V4, V5) për të monitoruar dhe përmirësuar ndikimin e shtrirjes të programit të IEK-së dhe përpjekjet e synuara të mobilizimit për të arritur veçanërisht grupet vulnerabel të identifikuar.

Nën-komponenti 2.3. Pilotimi i Shërbimeve Digjitale me në Qendër Qytetarët nëpërmjet qasjes të ngjarjeve jetësore

Ky nën-komponent synon të mbështesë zhvillimin e ofrimit të shërbimeve me në qendër qytetarin duke pilotuar një qasje të ngjarjeve jetësore⁵ si një efekt i rëndësishëm demonstrues i inovacioneve për ofrimin e shërbimeve të integruara proaktive që janë të qendrueshme ndaj ndërprerjeve në aksesin fizik në ndërtesat qeveritare. Në veçanti, ai do të përfshijë;

- (a) Analizen e përvojës globale në përdorimin e qasjes të ngjarjeve jetësore dhe finalizimin e shërbimeve që do të zgjidhen për mbështetje në kuadër të Projektit; grumbullimin e shërbimeve digjitale ekzistuese të lidhura me ngjarjen e përzgjedhur të jetës në portalin e-Kosova
- (b) Riinxhinierimin e shërbimeve rreth dy kategorive prioritare të shërbimeve të lidhura me ngjarjet e jetës (bazuar në kriteret e dakorduara me Qeverinë, duke përfshirë gatishmërinë e shërbimit elektronik; rëndësinë e shërbimit dhe kërkesën e përdoruesit për ndikim; dhe konsideratat gjinore dhe të përfshirjes së përgjithshme⁶), të tilla që paketa e shërbimeve të grumbulluara rreth ngjarjes së jetës të shpërndahet në një mënyrë proaktive pasi të verifikohet ngjarja nxitëse. Për çdo kategori të ngjarjeve të jetës, shërbimet e përzgjedhura shoqëruese do t'i nënshtrohen, aty ku është e nevojshme: (i) Përmirësimeve të TIK-ut dhe automatizimit për të rritur proaktivitetin, duke përfshirë aty ku është e mundur integrimin e metodave të machine-learning dhe inteligjencës artificiale për të përmirësuar rrugët e përdoruesve, për të ofruar sugjerime për kontekstin e përdoruesit, për të zbuluar anomalitë e

⁵ Qeveritë digjitale më të avancuara (përfshirë Estoninë, Danimarkën, MB, Singaporin, Australinë, Zelandën e Re) kanë kaluar vitet e fundit në ofrimin e shërbimeve që janë proaktive dhe të integruara rreth qytetarit ose përdoruesit që raportojnë një ngjarje të jetës, si p.sh. i martuar, duke u bërë prind i ri, duke blerë një shtëpi të re etj.

⁶ Kriteret për përzgjedhje: (i) ato ngjarje të jetës që janë më të "lehtë" për sa i përket organizimit të shërbimit elektronik, pronësisë institucionale, nivelit të automatizimit dhe gatishmërisë politike/ligjore, (ii) ato ngjarje të jetës që prekin një numër të konsiderueshëm përdoruesish dhe, (iii) ato ngjarje të jetës që ndikojnë në grupet vulnerabel të synuar të projektit, si gratë dhe personat me aftësi të kufizuara.

sjelljes së përdoruesit dhe parashikimin e ngarkesave të larta; (ii) racionalizimin dhe thjeshtimin administrativ; dhe (iii) mbështetje për ndryshimet e nevojshme rregulatore dhe ligjore.

Nën-komponenti 2.4. Inovacioni

Nën-komponenti do të mbështesë synimin e qeverisë për të krijuar një sektor inovacioni në ASHI për të shfrytëzuar zgjidhjet inovative të transformimit digjital për përmirësimin e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve publike. Në veçanti do të ofrojë mbështetje për:

- (a) krijimin e një sektori inovacioni brenda qeverisë si autoriteti përgjegjës për t'u angazhuar me zhvilluesit e interesuar dhe për të shfrytëzuar financime shtesë nga donatorët për zgjidhjet inovative që ekzistojnë aktualisht. Fushat e mundshme mund të përfshijnë: qëndrueshmërinë ndaj klimës, inovacionin në prokurimin e mallrave dhe shërbimeve digjitale, inovacionet në angazhimin e qytetarëve dhe mjetet e ofrimit të shërbimeve; dhe
- (b) Aktivitetet e zgjedhura që do të kontribuojnë në forcimin e ekosistemit të inovacionit duke shfrytëzuar kapacitetin e sektorit privat dhe të diasporës dhe promovimin e kulturës së inovacionit brenda qeverisë, të tilla si, ndër të tjera, (i) përdorimi i teknologjive frontier (teknologji e bazuar në satelit, IA, machine learning, big data); (ii) grumbullimi i ideve rreth politikave dhe strategjive publike, dhe (iii) përfshirja e sektorit privat për të adresuar sfidat e sektorit publik (start-ups).

- **Komponenti 3: Forcimi institucional, administrimi i ndryshimeve dhe menaxhimi i projektit**

Ky komponent do të ofrojë asistencë teknike me synimin për të mbështetur forcimin institucional dhe aktivitetet e administrimit të ndryshimit, të kërkuara për zbatimin e suksesshëm të Projektit dhe arritjen e rezultateve. Ai përfshin tre nën-komponentë:

Nën-komponenti 3.1. Forcimi institucional

Ky nën-komponent synon të ofrojë asistencë teknike të specializuar për të forcuar politikën e qeverisjes së të dhënave dhe kuadrin institucional të nevojshëm për nxitjen e transformimit digjital të qeverisë dhe shërbimeve, dhe për të nxitur një kulturë besimi dhe bashkëpunimi midis entiteteve publike. Kjo do të përfshijë, ndër të tjera:

- a) Forcimin e kuadrit institucional dhe ligjor të qeverisjes së të dhënave, ndër të tjera përmes; (i) krijimit të një organi të qeverisjes së të dhënave⁷, përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e një strategjie për qeverisjen e të dhënave; (ii) zhvillimin e një metodologjie për klasifikimin e të dhënave, zhvillimin e standardeve dhe protokolleve, si dhe përmirësimet në kuadrin ligjor dhe organizativ, (iii) rishikimin e kuadrit ligjor për të rritur përputhshmërinë me rregulloret përkatëse të BE-së; (iv) hartimin e masave të privatësisë dhe sigurisë, si dhe masave të tjera mbrojtëse ligjore dhe mundësuesit; (v) forcimin e Agjencisë për Informim dhe Privatësi; dhe (vi) hartimin dhe zbatimin e stimujve për menaxhim më të mirë të investimeve në TIK, siç është politika e kontrollit të shpenzimeve; dhe
- b) Forcimin e strukturës institucionale dhe koordinuese të parashikuar në strategjinë e e-Qeverisjes 2023-2027 (përfshirë ngritjen e Njesisë së Transformimit Digjital në Zyren e Kryeministrit).

Nën-komponenti 3.2. Administrimi i ndryshimit. Ky nën-komponent synon të mbështesë administrimin e ndryshimeve dhe proceset për ndërtimin e kapaciteteve të rëndësishme për sigurimin e suksesit të reformave të qeverisjes digjitale. Në veçanti, ky nën-komponent do të:

- a) Identifikojë menaxhimin e synuar të ndryshimit dhe mbështetjen për ndërtimin e kapaciteteve në lidhje me (i) aftësitë në nivelin e udhëheqjes për të planifikuar dhe zbatuar reformat në një mënyrë të kufizuar kohore (p.sh., zbatueshmëria e qasjeve me rezultate të shpejta); (ii) aftësitë menaxheriale (jo-IT ose jo të specializuara) për të mbështetur priorizimin e reformave dhe përzgjedhjen e shërbimeve që do të digjitalizohen, duke qenë kryesisht të përgjegjshme ndaj nevojave të përdoruesve; dhe (iii) aftësi më të

⁷ Organi i qeverisjes së të dhënave mund të jetë një institucion i ri ose një ekzistues për të marrë përsipër një përgjegjësi të tillë.

gjera teknike (përfshirë ato të lidhura me IT) që duhet të ekzistojnë brenda ministrive, departamenteve dhe agjencive kyçe për të ofruar një katalizator për miratimin më të gjerë të sistemeve të reja të IT-së dhe të gjithë platformës qeveritare të mbështetur përmes projektit.

Nën-komponenti 3.3 Menaxhimi i projektit. Ky nën-komponent synon të forcojë kapacitetet e Agjencisë të Shoqërisë së Informacionit për të menaxhuar Projektin. Në veçanti, ai do të përfshijë: pajisjen me personel të NjZP-së (duke përfshirë, ndër të tjera, ekspertizën për M&V, koordinimin teknik, planifikimin e projektit, prokurimin dhe menaxhimin e kontratave, dhe menaxhimin financiar).

4 VENDNDODHJA E AKTIVITETEVE TE PROJEKTIT

Zbatimi i Projektit për Forcimin e Qeverisjes Digjitale për Ofrimin e Shërbimeve do të ofrojë shërbime qeveritare digjitale për të gjithë popullatën në territorin e Kosovës.

Aktivitetet e projektit përfshijnë kryesisht mallra dhe shërbime konsulence. Projekti nuk parashikon punime të mëdha civile, por do të kufizohet në disa punime të rinovimit të objekteve ekzistuese (ambjentet për pajisjet, etj.) të cilat do të realizohen vetëm në Prishtinë dhe Deçan. Punimet fizike në shkallë të vogël në kuadër të Projektit do të përfshijnë: ngritjen e një qendre të përbashkët të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë (DRC) si një zgjidhje afatshkurtër për të pritur sisteme të kufizuara ose të zgjedhura të informacionit kritik të qeverisë. Objekti i back-up do të ngrihet në Deçan, duke përdorur një objekt ekzistues të pashfrytëzuar, të operuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe mund të ketë nevojë për disa punime rinovimi. Sistemet e rikuperimit afatshkurtër nga fatkeqësitë, të dhënat dhe informacioni (aplikacionet dhe shërbimet) do të kërkojnë pajisje shtesë për ruajtje dhe burime llogaritëse. Instalimi i hardware, software, pajisjeve të rrjetit dhe mobilimi gjithashtu do të jetë i nevojshëm për Qendrën e Kontaktit e-Kosova dhe QSHI-në që do të vendosen në një ndërtesë ekzistuese të qeverisë në Prishtinë. Vendndodhja e saktë e DRC dhe QSHI-se do të përcaktohen gjatë zbatimit të Projektit. Asnjë ndërtim i ri nuk do të jetë i nevojshëm për Projektin.

Faza e Operimit të projektit do të përfshijë ofrimin e shërbimeve qeveritare nëpërmjet metodave digjitale. Operimi i DRC-së do të jenë kryesisht pasiv, me monitorim dhe mirëmbajtje të vazhdueshme siç kërkohet nga stafi teknik i qeverisë. Në rast të ndërprerjes së energjisë, gjeneratori rezervë i DRC (me naftë) do të ndizet automatikisht për të siguruar që lidhja të ruhet gjatë gjithë kohës. Një sistem për shuarjen e zjarrit do të jetë pjesë e DRC-se për të siguruar të dhënat në çdo rast zjarri. Pas krijimit, QSHI-ja dhe Qendra e Kontaktit do të mirembahen gjatë gjithë kohës. Do të ketë nevojë për të zëvendësuar komponentët në momentin që ata arrijnë në fund të jetës së tyre të shërbimit.

5 TË DHËNAT BAZË MJEDISORE DHE SOCIALE

5.1 Të dhënat Bazë Mjedisore

Kosova është shteti më i ri në Evropë. Pas përvijës së saj si pjesë e ish-Jugosllavisë, Kosova u bë territor i pavarur nën administrimin e Kombeve të Bashkuara (OKB) në vitin 1999 dhe, në vitin 2008, shpalli pavarësinë. E vendosur në qendër të Evropës Juglindore, Kosova kufizohet me Shqipërinë në jug-perëndim, me Malin e Zi në veri-perëndim, me Serbinë në veri-lindje dhe me Maqedoninë në jug. Ka një sipërfaqe totale prej 10 905.25 km². Territori i Republikës së Kosovës karakterizohet nga lartësi të ndryshme mbi nivelin e detit. Pika më e ulët e Kosovës ndodhet në luginën e lumit Drini i Bardhë në kufi me Shqipërinë dhe arrin deri në 270 m mbi nivelin e detit, pika më e lartë është në Kosovën perëndimore - Gjeravicë - 2.656 m.

Në aspektin hidrografik, Kosova është e ndarë në katër basene lumore: Drini i Bardhë, Ibri, Morava Binçes dhe Lepeneci. Lumenjtë e Kosovës derdhen në tre dete të ndryshme: Deti i Zi, Deti Adriatik dhe Deti Egje. Kosova përfshin një zone ujëmbledhëse për rrjedhat ujore që rrjedhin nga vendet fqinje, por për shkak të topografisë së saj të ngritur, nuk merr ujë nga jashtë kufijve të saj. Ekziston vetëm një digë e madhe në Kosovë që është ndërtuar për të prodhuar energji hidroelektrike, por vendet fqinje kanë ndërtuar diga në lumenjtë e rrjedhës së poshtme të Kosovës. Shumë rrjedha lumenjsh janë ndërprerë rëndë nga minierat e rërës dhe zhavorrit dhe përpjekjet për të kontrolluar përmbytjet e lumenjve me argjinatura artificiale⁸.

Klima e Kosovës ndikohet nga afërsia e saj me detin Adriatik dhe Egje, si dhe nga masa kontinentale Evropiane në veri. Në pjesën më të madhe të vendit, klima është kontinentale, duke rezultuar në verë të ngrohtë dhe dimër të ftohtë, me ndikime mesdhetare dhe kontinentale. Temperatura mesatare brenda vendit varion nga +30°C në verë, në -10°C në dimër. Megjithatë, për shkak të lartësive të pabarabarta në pjesë të caktuara të vendit, ka ndryshime të temperaturës dhe shpërndarjes së reshjeve. Reshjet mesatare vjetore totale në Kosovë në vitin 2021 ishin 809.1 mm/vit, ndërsa në vitin 2020 ishin 663.3 mm/vit⁹, por në male sasia mesatare e reshjeve vjetore në Kosovë mund të arrijë më shumë se 1000 mm. Lartësitë e ndryshme, ndikimet klimatike dhe tokat brenda Kosovës ofrojnë një shumëllojshmëri të gjerë të mikrohabitateve në të cilat përshtaten specie bimore dhe shtazore.

Kosova është e prirur ndaj një shumëllojshmërie të gjerë të *rreziqeve natyrore* – duke përfshirë përmbytjet, rrëshqitjet e dheut, thatësitat, tërmetet dhe zjarret – që mund të paraqesin dëme serioze për ekonominë, balancat fiskale dhe mirëqenien e popullatave të cënueshme. Përmbytjet e menjëherëshme janë të zakonshme në zonat malore (ku reshjet mesatare vjetore janë deri në 1750 mm në vit) të cilat rezultojnë në rrëshqitje balte në disa zona. Kosova është gjithashtu e ekspozuar ndaj rrëshqitjeve të dheut, veçanërisht në zonat e Mitrovicës, Prishtinës, Pejës dhe Shtërpçës. Shumë nga këto rreziqe klimatike priten të rriten me ndryshimet klimatike në të ardhmen. Të paktën një e katërta e komuniteteve janë të ndjeshme ndaj rrëshqitjeve të dheut/rrëshqitjeve të shkëmbinjve me një probabilitet të shkallës së incidencës prej 1% (10% gjatë 10 viteve). Zonat fushore janë të prekura nga vërshimet e lumenjve, ndërsa Prishtina, Mitrovica, Podujeva dhe Dakovica kercenohen nga përmbytjet për shkak të cënueshmërisë nga struktura e digave. Në disa pellgje lumenjsh shumë të ekspozuar (si lumi Drin në gjysmën perëndimore të vendit) përmbytjet ndodhin çdo 2-3 vjet¹⁰. Këto rreziqe klimatike dhe fatkeqësi mund të ndikojnë seriozisht në sektorët prodhues të ekonomisë, si bujqësia, infrastruktura, energjia, burimet ujore, si dhe komunitetet dhe familjet. Fatkeqësitë natyrore dhe ndryshimet klimatike mund të pengojnë gjithashtu reformat dhe të shtojnë presionin mbi pozicionin fiskal, të përkeqësojnë presionet ekzistuese të shpenzimeve, duke ridrejtuar fondet publike larg planeve afatgjata të zhvillimit dhe duke kufizuar

⁸ Projekti i Ekonomisë Digjitalë të Kosovës

⁹ " Statistikat e Ujërave në Kosovë" për vitet 2020-2021, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

¹⁰ Raport Kerkimor i Drr mbi Legjislacionin dhe Përgjegjësitë e Palëve të Interesuara në Kosovë, 2018

aftësinë e vendit për të projektuar masa për programet e zhvillimit dhe nevojat e ardhshme. Ato gjithashtu mund të devijojnë kapacitetet e pakta administrative të qeverisë drejt operacioneve emergjente¹¹.

Problemet kryesore mjedisore

Kosova përballlet me një sërë rreziqesh mjedisore, si më poshtë;

Ndotja e ajrit është një problem i rëndësishëm në zonat urbane të Kosovës dhe mesatarisht një problem për vendin në tërësi. Cilësia e ajrit të ambientit urban është e ulët veçanërisht në Prishtinë, në zonën e Obiliqit, në zonën e Drenasit dhe në Mitrovicë. Burimet kryesore të ndotjes përfshijnë; djegien e drurit dhe linjitet për qëllime të ngrohjes së banesave shtëpiake/ndërtesave; tymi dhe emetimet nga komplekset e mëdha industriale; landfillet e mbeturinave urbane dhe industriale të cilat priren të kenë ndikime më specifike lokale; dhe emetimet e automjeteve. Mesatarja e emetimeve të gazeve serrë në Kosovë është rreth 9.5 milionë tonë ekuivalent CO₂. Burimi kryesor i emetimeve të gazeve serrë është sektori i energjisë me një peshë prej 88% të emetimeve totale. Sektori i dytë është bujqësia me 7%¹².

Cilësia e Ujit. Ndotja e ujit të pijshëm në përgjithësi shoqërohet me ndotje bakteriale dhe jo kimike. Pjesa më e madhe e këtij kontaminimi bakterial (fekal) ndodh në sistemet e furnizimit me ujë të qyteteve të vogla dhe zonave rurale ku një pjesë e madhe e puseve dhe burimeve mendohet të jenë të kontaminuara. Po ashtu, në Kosovë mungon funksionimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza.

Mbetjet e rrezikshme të patrajuara dhe mbetjet komunale. Mbetjet industriale historike dhe aktuale kanë mbetur - për periudha të gjata kohore - në vendet e prodhimit, zonat e depozitimit dhe pikat e nxehta industriale. Aktualisht, ekziston një mungesë pothuajse totale e menaxhimit të duhur të mbeturinave në Kosovë për të gjitha llojet e mbeturinave – mbeturinat shtëpiake, industriale, të kujdesit shëndetësor dhe të rrezikshme – si dhe për ndotjen e trashëguar nga kontaminimi historik. Nëse praktika aktuale e menaxhimit të mbetjeve mbetet e pandryshuar, kjo mund të çojë në nivele të larta të ndotjes së ujërave nëntokësore dhe ajrit (për shembull, përmes metanit ose gazit të landfillit, por edhe dioksinave dhe grimcave të imëta gjatë diegies).

Burimet pyjore janë nën presion që nga viti 1990, një pjesë e madhe e lëndës drusore janë prerë ilegalisht për tu përdorur për dru zjarri, dhe po ashtu ka pasur prerje masive të pemëve të përdorura për rindërtimin e shtëpive pas periudhës të luftës. Për më tepër, për trajtimin e duhur të silvikulturës, kërkohet veçanërisht rrallimi parakomercial në fazën e re të zhvillimit të pyjeve për të rikthyer menaxhimin dhe rritjen e dëshiruar të pyjeve.

5.1.1 *Menaxhimi i Mbetjeve*

Pavarësisht progresit të bërë, sistemi i menaxhimit të mbetjeve në Kosovë është i nënfinancuar. Vetëm disa landfille kanë tarifa të përcaktuara për sasinë e mbetjeve që hyjnë në strukturën e përpunimit të mbetjeve, të cilat mbulojnë vetëm koston bazë të menaxhimit të landfillit, pa parashikuar ndonjë përkujdesje të mëvonshme. Për grumbullimin e mbeturinave, nuk ekziston asnjë sistem "paguaj sa hedh"; familjet paguajnë një tarifë fikse mujore për shërbimin e grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve. Komunitatet dhe kompanitë e licencuara janë përgjegjëse për organizimin e grumbullimit të mbeturinave komunale. Në zonat urbane mbetjet grumbullohen përmes pikave të përbashkëta të grumbullimit, ndërsa në zonat rurale grumbullimi bëhet derë më derë. Progresi i rëndësishëm është bërë në zgjerimin e mbulimit me shërbimin e grumbullimit, i cili raportohet të jetë mbi 80 % e popullsisë që nga viti 2019. Nuk ekziston një sistem zyrtar për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.

¹¹ Diagnostikimi Sistematik i vendit, Republika e Kosovës, Janar 2017 – Banka Botërore

¹² Strategjia e Ndryshimeve Klimatike e Kosovës 2019- 2028 dhe Plani i veprimit për Ndryshimet Klimatike 2019- 2021. MMPH 2018

Fondet e BE-së janë përdorur për të zhvilluar katër landfille të reja sanitare dhe një stacion transferimi, ndërsa dy landfille shtesë u ndërtuan duke përdorur fonde e donatorëve të tjerë. Të katër lanfilllet e reja u financuan nga Agjencia Evropiane për Zhvillim. Megjithatë, në kohën e ndërtimit, të katër landfilllet e Kosovës nuk posedonin dhe as nuk kishin të drejtë të merrnin një leje të integruar mjedisore nga qeveria, sepse ato nuk ishin ndërtuar në përputhje me standardet dhe nuk ishin këshilluar fillimisht nga MMPH¹³. Landfilli në Mirash, i cili është ndër më të mëdhenjtë në Kosovë, është në kushte më të përkeqësuar, i cili mban sasi të konsiderueshme të ujit dhe sasi të madhe të mbetjeve të hedhura, që paraqet një kërcënim të madh për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve.

Aktualisht, pothuajse të gjitha mbeturinat e ngurta komunale (MNK) të grumbulluara në Kosovë depozitohen në landfill, qoftë edhe në një nga vendet ilegale të depozitimit në rritje (rreth 10 %) ose në vendodhje josanitare të përcaktuara zyrtarisht (50 %). Kosova ka rrezik të jetë afër shterjes së kapaciteteve të landfilleve të saj. Përveç kësaj, landfilllet ekzistues nuk menaxhohen në përputhje të plotë me kërkesat e Direktivës së BE-së për Landfilllet. Ka nevojë për përmirësime në menaxhimin e infrastrukturës, për të konsoliduar kompanitë publike, për të kontraktuar operatorët ekonomikë, për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të stimuluar riciklimin¹⁴. Inspektimet nuk janë të mjaftueshme për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe trajnimeve të stafit. Përsa i përket trajtimit të mbeturinave, ky proces nuk është shumë ekzistent. Të gjitha mbetjet komunale përfundojnë në një landfill sanitar pa diferencim dhe trajtim paraprak. Diferencimi dhe grumbullimi i rrymave të ndryshme të mbeturinave, të tilla si; MPEE, bateritë, plastika, metalet dhe letra kryhet nga sektori privat në kontejnerë dhe nga pastruesit në vendgrumbullime.

Menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme mbetet problematik. Kosova nuk është palë në Konventën e Bazelit dhe duke pasur parasysh mungesën e objekteve të përshtatshme për trajtimin/deponimin, ekziston nevoja për të eksportuar mbetje të rrezikshme. Statusi i Kosovës në Konventë e bën situatën më të rënduar se sa do të ishte rasti, dhe me shumë mundësi, e rrënjos drejtimin për depozitimin e papërshtatshëm për një periudhë të pacaktuar. Një projekt i financuar nga IPA për ndërtimin e kapaciteteve të magazinimit/menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme është në zhvillim, por vendi i depozitimit nuk është krijuar ende.

Mbetjet elektronike. Kosova ka pesë kompani të licencuara për grumbullimin dhe përpunimin e mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike (MPEE). Aktualisht nuk ka skema grumbullimi, qendra apo objekte për çmontimin dhe nuk ka të dhëna për llojet dhe sasi të MPEE-ve. Rrjedhat e ndryshme të MPEE-ve çmontohen manualisht në shkallë të ndryshme. Veprimtaria drejtohet nga përpjekjet manuale në funksion të çmontimit dhe nga vlera materiale e fraksioneve të caktuara (p.sh. çeliku, alumini dhe bakri)¹⁵. MPEE-të përbëjnë një rrymë të rëndësishme mbetjesh që duhet menaxhuar në mënyrë profesionale. Shumë mbetje të pajisjeve elektronike përmbajnë materiale të rrezikshme që kërkojnë menaxhim të specializuar. Aktualisht, ka një udhëzim administrativ të miratuar për të filluar një skemë të përgjegjësive të zgjeruar të prodhuesit (PZP) për MPEE-të. Nuk ka asnjë grumbullim të diferencuar zyrtar të dedikuar për asnjë nga rrymat e mbetjeve si MPEE, bateritë dhe automjetet në fund të jetës.

Vetëm një kompani është e licencuar për grumbullimin e baterive, ndërsa gjashtë për akumulatorët. Aktualisht nuk ka asnjë sistem etiketimi dhe shënimi apo ndonjë bazë të dhënash për sasi të importuara. Nuk ka qendra grumbullimi dhe nuk ka të dhëna për sasi të instrumentet ekonomike në përdorim. Sipas Ligjit të Kosovës për Mbeturinave, Bateritë duhet të përpunohen dhe trajtohen vetëm nga persona të licencuar. Megjithatë, në vend nuk ka asnjë subjekt të veçantë për trajtimin e baterive. Shumica e baterive përfundojnë në kontejnerë të MNK, nga ku personat që mbledhin mbeturina i grumbullojnë ato dhe ua shesin grumbulluesve të skrapit (të pa

¹³ Menaxhimi i Mbeturinave; Identifikimi i sfidave të Sektorit, Maj 2018, Instituti për Politika Zhvillimore

¹⁴ Strategjia (2021-2030) dhe Plani i Veprimit (2021-2023) për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë, miratuar më 05.2021

¹⁵ https://ec.europa.eu/environment/enlarg/pdf/pilot%20waste/Kosovo_en.pdf

licencuar) që operojnë në Kosovë. Ka edhe disa tregëtarë ku qytetarët mund të çojnë bateritë e vjetra dhe të përfitojnë zbritje për bateritë e reja.

Aspektet sociale të menaxhimit të mbeturinave

Mbledhësit informalë të mbetjeve luajnë një rol të rëndësishëm në grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme. Vlerësohet se rreth 2 000 individë mund të jenë të angazhuar individualisht në grumbullimin joformal në mbarë Kosovën, por nuk ka të dhëna apo llogaritje zyrtare për të vlerësuar nivelin e aktivitetit. Këta mbledhës të mbeturinave janë zakonisht njerëz të varfër, nga komunitete të ndryshme të marginalizuara dhe nga komuniteti Rome. Ata mbledhin plastikë, metale, letër dhe karton, bateri dhe MPEE, etj., dhe ua shesin kompanive të vogla dhe të mesme të licencuara, zakonisht për eksport. Me shumë mundësi, në këto aktivitete është përfshirë edhe personeli nga shërbimet formale të grumbullimit të mbetjeve. Disa grumbullues mbetjesh hyjnë edhe në ambientet e landfillit për të mbledhur mbetjet dhe për t'ua shitur ato tregtarëve të mbetjeve. Me kalimin e kohës, sektori informal ka ndryshuar mënyrën e tij të punës. Sot ai është i organizuar në grupe që mbledhin mbetjet dhe i ndajnë ato në fraksione mbetjesh dhe më pas ua shesin përpunuesve apo tregtarëve të tjerë. Iniciativat e kufizuara që synojnë të integrojnë grumbulluesit informalë të mbetjeve në sistemin ekzistues të menaxhimit të mbetjeve nuk kanë qenë të suksesshme deri më tani¹⁶.

5.2 Të Dhënat Bazë Sociale

Sipas ndarjes administrative, Kosova përbëhet nga 38 komuna me 1,469 vendbanime të organizuara nga ligjet e vendit. Sipas vlerësimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), popullsia rezidente në Kosovë përbën rreth 1.78 milionë banorë. Pas periudhës së vitit 1990, Kosova është ballafaquar me çështjen e migrimit që pati ndikim si në strukturën e popullsisë ashtu edhe në ritmin e rritjes së saj. Lëvizja e lirë dhe e pakontrolluar e popullsisë ndryshoi raportin midis popullsisë urbane dhe rurale. Sipas regjistrimit të popullsisë, të realizuar në Prill 2011, 61% e popullsisë jeton në zonat rurale. Në vitin 2020 kishte 365.627 familje në mbarë Kosovën. Madhësia mesatare e familjeve ishte 4,92. Në vitin 2020 (sipas të dhënave të ASK-së) dendësia mesatare e popullsisë së Kosovës ishte rreth 164,90 njerëz për km². Përqendrimi më i lartë i popullsisë është në kryeqytetin e Prishtinës me rreth 218.782 banorë (të dhënat e ASK-së, 2020), e ndjekur nga Prizreni - 194.581 banorë. Përafërsisht 91%¹⁷ e popullsisë së Kosovës janë etnikë shqiptarë. Gjuha shqipe njihet si gjuhë zyrtare së bashku me serbishten (3.4% e popullsisë janë Serbë). Gjuhë të tjera, duke përfshirë turqishten, gjuhën rome dhe boshnjake, fliten gjithashtu nga rreth 5.6 përqind e popullsisë e cila përfaqësohet nga boshnjakët, turqit, ashkalinjtë, egjiptianët, goranët dhe romët.

Emigrimi në Evropën Perëndimore mbetet një karakteristikë e rëndësishme demografike e popullsisë së Kosovës. Shifra zyrtare, e cila bazohet në të dhënat e regjistrimit të vitit 2011, tregon se janë rreth 550 000 kosovarë që jetojnë jashtë vendit, mbi 35% e të cilëve banonin në Gjermani, pasuar nga Zvicra (rreth 23%), Italia, Austria dhe Suedia. Kushtet socio-ekonomike, mundësitë e ulëta të punësimit dhe paqëndrueshmëria politike duket se janë faktorët kryesorë që nxisin migrimin.

Kosova është aktualisht vendi më i ri në Evropë. Përafërsisht, 40 për qind e popullsisë i përkasin grupmoshës 24 vjeç ose më të re dhe vetëm 7 për qind moshës më të vjetër se 65 vjeç. Kështu që popullsia përfaqëson shpresë

¹⁶ Menaxhimi i Mbetjeve Komunale në vedet e Ballkanit Perëndimor — Profili i vendit, Nëntor 2021, Agjencia Europiane e Mjedisit

¹⁷ Të dhënat e Censurit 2011- Popullsia e Kosovës sipas përkatësisë etnike

dhe burim të rëndësishëm për prosperitetin e ardhshëm. Moshë mesatare e popullsisë është 30.2 vjeç¹⁸. Raporti gjinor i popullsisë për vitin 2019 është 95.3 femra për 100 meshkuj.

Kosova renditet e 85-ta në Indeksin e Zhvillimit Njerëzor të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), ndër më të ulëtat në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Kosova ka statusin më të ardhurat mesatare më të ulëta¹⁹. Jetëgjatësia u rrit nga 67 në 72 vjet midis 1999 dhe 2017 dhe shkalla e varfërisë është 29.7%. Nga viti 2008, Kosova ka zhvilluar disa reforma, por mbeten ende barriera të rëndësishme për zhvillim. Informaliteti, rritja e korrupsionit apo interesave private që ndikojnë ndjeshëm në proceset vendimmarrëse janë kufizimet kryesore për shpenzimet publike. Sfidat tjera përfshijnë; mangësitë e mëdha në infrastrukturë; një furnizim jo i besueshëm me energji me bazë qymyri; dhe pjesëmarrje e ulët në fuqinë punëtore dhe papunësi e lartë, veçanërisht midis punëtorëve të rinj.

5.2.1 Grupet e Cënuara/Vulnerabël

Kosova mbetet një nga vendet më të varfra në Evropë, me rreth 23 për qind të popullsisë që jeton në varfëri dhe disa grupe të cënueshme që përballen me rrezikun në rritje të përjashtimit social dhe varfërisë. Përkundër dispozitave ligjore dhe masave në fuqi për të siguruar mundësi të barabarta dhe qasje në tregun e punës, qasja e barabartë nuk arrihet për disa grupe; si gratë, të moshuarit dhe të rinjtë, personat me nevojat të veçanta dhe pjesëtarët e komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptian.

Bazuar në të dhënat e Anketës së Buxhetit të Familjeve (ABF) 2017²⁰, vlerësohet se 18.0 përqind e popullsisë së Kosovës jeton nën kufirin e varfërisë (1.85 € në ditë), me 5.1 përqind të popullsisë nën kufirin e varfërisë ekstreme. Normat e varfërisë ekstreme dhe varfërisë janë më të larta në vendbanimet rurale. Gjatë gjithë periudhës 2012-2017, pabarazia është ulur lehtë. Pabarazia në zonat urbane ishte më e lartë se në zonat rurale. Është vërejtur në ulje e pabarazisë në zonat rurale, por kjo u kompensua nga rritja e pabarazisë në zonat urbane. Rreth 11.8 për qind e të varfërve raportojnë të ardhurat nga ndihma sociale si burimi kryesor i të ardhurave në familje.

Ekziston një lidhje e qartë ndërmjet arsimit dhe incidencës së varfërisë në Kosovë. Individët më pak të arsimuar priren të jenë më të varfër se ata më të arsimuar. Shumica e të varfërve kanë përfunduar vetëm arsimin fillor ose më pak (55.5 përqind). Në vitin 2017, shkalla më e lartë e varfërisë ishte për individët e papunë dhe ata të punësuar të rastësishëm, përkatësisht 25.5 dhe 19.6 për qind. Nga viti 2016 deri në vitin 2017 është rritur shkalla e varfërisë tek pensionistët dhe individët e papunë. Gratë janë të nënpërfaqësuar në tregun e punës, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik. Në vitin 2017, 18.9 për qind e grave në Kosovë jetojnë në varfëri në krahasim me 17.2 për qind të burrave, një diferencë prej gati dy për qind; Personat me aftësi të kufizuara kanë pengesa për punësim dhe e njëjta gjë vlen edhe për pjesëtarët e pakicave etnike, veçanërisht pjesëtarët e komunitetit Rome, Egjiptian dhe Ashkali. Sipas Strategjisë për Përfshirjen e komuniteteve Rome dhe Ashkali 2017-2021, shkalla e punësimit dhe cilësia e vendeve të punës të pjesëtarëve të komunitetit Rom dhe Ashkali ishte mjaftueshëm nën mesataren.

Shumica e pjesëtarëve të komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptian jetojnë në kushte të varfërisë ekstreme duke u përballur me vështirësi në plotësimin e nevojave të tyre ushqimore dhe nevojave të tjera elementare.

¹⁸ <https://ask.rks-gov.net/media/6118/women-and-man-2018-2019.pdf>

¹⁹ OECD Development Co-operation Peer Reviews: 2020, <https://www.oecd-ilibrary.org/sites/c3aef350-en/index.html?itemId=/content/component/c3aef350-en>

²⁰ Agjensia e Statistikave të Kosovës <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/poverty-statistics-2012-2017>

Përkundër skemave të mirëqenies sociale që shërbejnë për zbutjen e nivelit të varfërisë në Kosovë, vetëm 8% e Romëve dhe Ashkalive kanë përfituar nga ndihma sociale në vitin 2015²¹.

5.2.2 *Ekonomia*

Në dekadën para pandemisë (2010-2019), Kosova pati rritje me një mesatare prej 4.6 për qind në vit, që përkthehet në një rritje prej gati 50 për qind të të ardhurave për kokë banori dhe një ulje prej 35 për qind të shkallës së varfërisë. Rritja ekonomike ka qenë kryesisht e nxitur nga konsumi. Në mes të pandemisë, produkti i brendshëm bruto (PBB) u tkurr me 5.3 për qind në 2020, duke çuar në recesionin e parë të vendit që nga pavarësia, duke përmbysur fitimet e fituara me vështirësi në uljen e varfërisë dhe duke demtuar pozicionin fiskal të vendit. Pandemia shkaktoi dëme të qëndrueshme në arritjet arsimore dhe tendosi sistemin e përkujdesit shëndetësor.

Ekonomia dominohet nga shërbimet. Që nga viti 2021, shërbimet përbënin afërsisht gjysmën e PBB-së, të ndjekura nga industria dhe ndërtimi (19 për qind dhe 8 për qind, respektivisht). Struktura e PBB-së mbeti kryesisht e pandryshuar nga viti 2009 në 2021, me përjashtim të bujqësisë. Sektori i prodhimit është i përqendruar në industritë me vlerë të ulët të shtuar, me disa industri të spikatura si; përpunimi i ushqimit, pijeve dhe metaleve. Vitet e fundit, prodhimi i mobiljeve është shfaqur si një nxitës i ri i prodhimit dhe eksporteve të prodhimit.

Një rimëkëmbje e fuqishme ndodhi në vitin 2021 falë një sektori të jashtëm mbështetës. PBB-ja u rrit me 10.5 për qind në vitin 2021²². Mbështetja e fortë nga diaspora në formën e remitançave, turizmit, kompensimeve të migrantëve sezonalë dhe investimeve në pasuri të paluajtshme i dhanë një shtysë të konsiderueshme aktivitetit ekonomik. Flukset hyrëse të remitançave nga jashtë arritën në 14.6 për qind të PBB-së në vitin 2021, duke mbështetur të ardhurat dhe konsumin e familjeve. Ndërsa paratë e dërguara nga jashtë, në vlera të larta ndihmojnë në mbështetjen e rritjes së konsumit dhe financojnë deficitin tregtar, ato gjithashtu mbajnë rezerva te larta për pagat, duke dhënë kështu kontribut ndaj punësimit të ulët. Eksportet e shërbimeve gati u dyfishuan në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 për shkak të vizitave nga diaspora. Pavarësisht, se eksportet e mallrave mbeten ende në norma relativisht të ulta (me 9.6 për qind të PBB-së në vitin 2021), megjithë rritjen (nga 5.8 për qind e PBB-së në 2016), ato kanë shënuar norma rritjeje vjetore shumë pozitive prej 24 për qind në 2020 dhe 58 për qind në 2021. Ndërsa muajt e parë të vitit 2022 u karakterizuan nga vazhdimi i rritjes së fortë të kredisë dhe remitançave, kjo u balancua kundrejt presioneve të forta të inflacionit, të përkeqësuar nga ndikimi ekonomik i luftës në Ukrainë. Rreziqet kryesore për perspektivën lidhen me pasiguritë gjeopolitike në rritje, rritjen e çmimeve të mallrave, dobësitë e vazhdueshme në fushën e menaxhimit të investimeve publike dhe dobësitë e mundshme në sektorin e jashtëm.

5.2.3 *Arsimi*

Sistemi arsimor në Kosovë është i organizuar sipas 5 niveleve kryesore: Arsimi Parashkollor; Arsimi fillor; Arsimi i mesëm i ulët; Arsimi i mesëm i lartë; Arsimi i Lartë (niveli Bachelor, niveli Master dhe niveli Doktoraturë).

Bazuar në Statistikat e Arsimit të Kosovës 2020/21²³, rezulton se rreth 320 mijë fëmijë/nxënës janë të përfshirë në arsimin parauniversitar në Kosovë, mbi 95% e të cilëve vijnë në arsimin/shkollën në 1052 Institucione Arsimore dhe Trajnuese publike (IAT); ndërsa 16,424 fëmijë/nxënës ndjekin arsimin/shkollën në IAT-të private të

²¹ STRATEGJIA PËR PËRFSHIRJEN E KOMUNITETIT ROM DHE ASHKALI NË SHOQËRINË E KOSOVËS 2017-2021, Republica e Kosovës 2017

²² Diagnostifikimi i vendit të Kosovës: Sfidat dhe mundësitë e investimeve private 2022, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)

²³ Draft Strategjia e Arsimit 2022-2026, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Kosovës

licencuara. Shkalla e përfshirjes së fëmijëve në arsimin parashkollor është 88,1%, ndërsa në arsimin e mesëm të ulët 91,2%. Në vitin akademik 2020/21, në institucionet e akredituara të arsimit të lartë në Kosovë vijojnë studimet 95.335 studentë (57.4% në sektorin publik, 42.6% në sektorin privat), prej të cilëve 58.5% janë studente femra. Pjesëmarrja e studentëve femra në arsimin e lartë është në nivele të kënaqshme.

Shkollat në gjuhën serbe në Kosovë vazhdojnë të funksionojnë jashtë sistemit arsimor të Kosovës, përkundër faktit se legjislacioni aktual ofron mundësi të mëdha për të akomoduar nevojat specifike të komunitetit serb.

Ndonëse vitet e fundit pjesëmarrja e vajzave në arsim është pothuajse e njëjtë me djemtë, niveli i arsimimit të femrat e moshës 15-64 vjeç është dukshëm më i ulët se ai i meshkujve, duke ndikuar negativisht në mundësitë e tyre për punësim.

Mësimi në distancë gjatë Covid 19 rriti hendekun e njohurive midis fëmijëve në avantazh dhe atyre nga grupet e cenueshme, duke përfshirë; fëmijët me status të ulët socio-ekonomik, fëmijët me nevoja të veçanta arsimore dhe fëmijët nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane të cilët për arsye të ndryshme nuk arritën të përfshihen në arsimin në distancë. Pjesëmarrja e komuniteteve Ashkali dhe Egjiptiane në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, mbetet e ulët krahasuar me mesataren kombëtare. Në arsimin parashkollor rreth 7.6% e fëmijëve të këtyre komuniteteve marrin shërbime, ndërsa në arsimin e mesëm vetëm 31%. Janë ngritur qendra mësimore në komuna të ndryshme të Kosovës ku jetojnë komunitetet Rome, Ashkali dhe Egjiptiane, në mënyrë që fëmijët e këtyre komuniteteve të përfshihen në sistemin arsimor.

Përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara mbetet një sfidë e madhe në nivel kombëtar, me rreth 2.1% të këtyre nxënësve të përfshirë në arsim. Vlerësohet se 38,000 fëmijë me aftësi të kufizuara në Kosovë nuk ndjekin shkollën. Shumica e institucioneve arsimore (në të gjitha nivelet) nuk ofrojnë infrastrukturë të përshtatshme fizike për studentët. Gjithashtu, mungojnë materialet mësimore për studentët me aftësi të kufizuara në shikim dhe dëgjim, si; mungesa e leksioneve të digjitalizuara ose të regjistruara në gjuhën shqipe dhe e materialeve mësimore në braille²⁴.

Cilësia e arsimit mbetet një sfidë urgjente për Kosovën. Sipas rezultateve të Programit të OECD-së për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve (PISA) 2018, 79% e studentëve kosovarë nuk mundën të arinin nivel minimal të shkathtësidë në lexim, krahasuar me 23% të studentëve në ekonomitë e OECD; 77% deshtuan të arinin nivelet minimale në matematikë krahasuar me 24% në ekonomitë e OECD dhe 77% deshtuan në shkenca krahasuar me 22% në ekonomitë e OECD.

5.2.4 Shërbimi shëndetësor dhe kujdesi shëndetësor

Shërbimet shëndetësore në Kosovë ofrohen përmes një sërë institucionesh shëndetësore të organizuara në tri nivele: kujdesi shëndetësor parësor, kujdesi shëndetësor dytësor dhe kujdesi shëndetësor tretësor. Shërbimet e kujdesit shëndetësor ofrohen në institucionet shëndetësore publike dhe private. Në të gjithë vendin, ekzistojnë shtatë spitale publike rajonale dhe një spital universitar në Prishtinë. Rrjeti publik i Kujdesit Parësor Shëndetësor përbëhet nga gjithsej 429 institucione. Secila komunë e Kosovës ka një njësi kryesore 'Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare' dhe njësitë përbërëse të saj: Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe Ambulancat e Mjekësisë Familjare. Kujdesi shëndetësor terciar përfshin kujdesin e avancuar shëndetësor, spitalor, ambulator dhe shëndetësor publik, si dhe shërbimet konsullore në nivelin terciar të kujdesit shëndetësor. Përveç institucioneve publike shëndetësore, kujdesi shëndetësor në Kosovë ofrohet edhe nga institucionet shëndetësore private të licencuara. Në sektorin primar, me përjashtim të grupeve vulnerabël të popullsisë që përjashtohen me ligj, pacientët paguajnë tarifa përdoruesi (bashkëpagesë) prej 1 euro. Tarifat e kujdesit dytësor

²⁴ Performanca e Ekonomive të Ballkanit Perëndimor në lidhje me Shtyllën Evropiane të Drejtave Sociale, Rishikimi 2021 për Kosovën, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal

dhe tretesor varen nga lloji i trajtimit dhe institucioni mjekësor. Vlerësohet se 18% e popullsisë nuk kërkon shërbime edhe në rast sëmundjeje, për arsye ekonomike²⁵. Shkalla e sëmundshmërisë në Kosovë është më e ulëta me gjithsej 422 raste për 100,000 banorë në vitin 2011 krahasuar me BE-në me 663 raste për 100,000 banorë. Sëmundjet më të shpeshta për popullatën e Kosovës janë; sëmundjet e rrugëve të frymëmarrjes, sistemit tretës, qarkullimit të gjakut dhe sistemit muskuloskeletor. Sa i përket faktorëve të rrezikut të gjendjes shëndetësore, problemet kryesore në Kosovë janë pirja e duhanit, përdorimi i drogës, mjedisi dhe aksidentet në trafik. Në Kosovë në vitin 2015 janë raportuar 127,449 (7374.5/100,000 banorë) raste të sëmundjeve ngjitëse, të cilat janë kërcënim permanent për popullatën. Sëmundjet që vijnë nga uji dhe ushqimi vazhdojnë të kryesojnë me numrin më të madh të rasteve.

5.2.5 Barazia Gjinore

Përfaqësimi politik (kuvendi legjislativ apo pozitat vendimmarrëse) i grave në Kosovë mbetet më i ulët në krahasim me përfaqësimin e burrave. Shpesh, pabarazitë sociale, kulturore dhe ekonomike ndikojnë në zotërimin e të drejtave në realitet. Në takimet me komunitetin në zonat rurale, pjesëmarrja e grave vlerësohet të jetë rreth 5 deri në 10% krahasuar me 90 deri në 95% pjesëmarrje të burrave. Shkalla e varfërisë për familjet me kryefamiljare gra është më e lartë, përkatësisht 23.7 për qind, krahasuar me 17 për qind të familjeve me kryefamiljar burra. Gratë janë në pozitë të pafavorshme, krahasuar me burrat, në aksesin në tregun e punës. Të dhënat e ASK-së të tremujorit të dytë (TM2), 2022 tregojnë se shkalla e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës është dukshëm më e ulët se ajo e meshkujve (44.0% e meshkujve në moshë pune ishin të punësuar krahasuar me 16.0% e femrave në moshë pune). Për 40 për qind të grave, kujdesi dhe përgjegjësitë familjare janë arsyt kryesore të mos-aktivizimit në tregun e punës. Kryesisht për shkak të detyrimeve familjare, punësimi me kohë të pjesshme është më i theksuar tek femrat. Në vitin 2016, vetëm 11 për qind e grave ishin pronare të shtëpive/banesave, ndërsa sipas të dhënave nga Censusi i bujqësisë në vitin 2014, vetëm 4.9 për qind e tokës bujqësore zotërohej nga gratë.

Shoqëria kosovare vazhdon të afirmojë apo tolerojë dhunën si mënyrë për të kontrolluar dhe mbajtur gratë në pozitën e tyre shoqërore. 80% e personave që kanë raportuar dhunë gjatë viteve 2016-2017 kanë qenë gra. Pavarësisht se ngacmimi seksual është përcaktuar në Kodin e ri Penal, identifikimi dhe trajtimi i rasteve të ngacmimeve seksuale mbetet një sfidë. Edhe pse ende nuk ka të dhëna zyrtare të mbledhura dhe të raportuara rregullisht, hulumtimi i udhëhequr nga sektori joqeveritar tregon se rreth 64% e grave dhe vajzave kanë përjetuar një formë të ngacmimit seksual gjatë jetës së tyre²⁶.

5.2.6 Qasja dhe përdorimi i shërbimeve digjitale

Në përgjithësi, nivelet e qasjes në internet janë të larta në Kosovë; vendi aktualisht renditet i 40-ti në botë për sa i përket penetrimit të internetit dhe aftësive të shkrim-leximit. Sipas raporteve të fundit²⁷, në vitin 2021 96.1% e familjeve kishin akses në internet nga shtëpia apo banesa krahasuar me vitin 2020 që ishte 96.4%, ndërsa 2.1% e familjeve deklaruan se nuk kishin akses në internet. Nga 96.1%, 94% e familjeve janë shërbyer përmes lidhjes fikse të internetit. Kosova ka bërë përparime të rëndësishme në zgjerimin e lidhjes me brez të gjerë (broadband) me mbështetjen e Projektit të Ekonomisë Digjitale të Kosovës (KODE). Rreth 79 për qind e individëve përdorin një telefon celular për të hyrë në internet në vitin 2019, megjithëse me një hendek të vogël në përdorim sipas gjinisë (80 për qind e meshkujve të moshës 16 deri në 74 vjeç kundrejt 77 për qind e femrave). Sipas të dhënave të Anketës Digjitale të Familjeve të UNDP-se, aksesin në internet në zonat rurale për vitin 2021 ishte në nivelin 99,31% (lidhja me Wifi 100%, LTE 3G/4G-37,5%), dhe 99,86% në zonat urbane. Femrat kanë më shumë gjasa se

²⁵ Performanca e Ekonomive të Ballkanit Perëndimor në lidhje me Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale, Rishikimi 2021 mbi Kosovën, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal

²⁶ PROGRAMI I KOSOVËS PËR BARAZI GJINORE 2020-2024, Zyra e Kryeministrit, Agjencia për Barazi Gjinore

²⁷ Rezultatet e Anketës të Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, 2021, Agjencia e Statistikave të Kosovës

burrat t'i konsiderojnë laptopët si të papërballueshëm (33.3 përqind e femrave kundrejt 24 përqind e meshkujve). Përdorimi i internetit është më i lartë për grupmoshat 35-44 vjeç me 19.5%²⁸; ndërkohë që ka një rritje prej 0,9% për grupmoshën 65+ në 10,1% në 2020 krahasuar me 9,2% në 2019. Edhe pse është regjistruar një përmirësim i qëndrueshëm i përqindjes së njerëzve mbi 65 vjeç që përdorin internetin në shtëpi, ky grup kryesisht mbetet i përjashtuar nga shoqëria digjitale për shkak të nivelit të tyre në aftësitë digjitale. Sa i përket aksesueshmërisë së portalit e-Kosovo, 75% e njerëzve në zonat urbane e kanë përdorur ndonjëherë platformën eKosova, krahasuar me 65% të atyre në zonat rurale (anketimi i UNDP). 99% e atyre me arsim universitar/të lartë përdorin internetin, ndërsa vetëm 76% e atyre me arsim parashkollor përdorin internetin (Shoqata e TIK-ut e Kosovës dhe Indeksi i KANTAR Kosove, 2019). Përqindja e individëve me aftësi bazë digjitale në Kosovë renditet më e ulëta në mesin e ekonomive të BB-së me 13% në vitin 2019. Përqindja e individëve me aftësi mbi nivelin bazë të njohurive digjitale perben 14% të individëve në Kosovë që i përkisnin kësaj kategorie në vitin 2019. Individët e klasifikuar si me aftësi të ulëta digjitale në vitin 2019 përbënin 59%, krahasuar me mesataren e BE-së prej 29%, dhe kjo është edhe përqindja më e lartë midis vendeve të Ballkanit Perëndimor²⁹.

Mbulimi me internet për komunitetet Rome dhe Ashkali është rreth 88%, pak më i ulët se të dhënat kombëtare, posedimi i laptopit prej 27% si dhe përdorimi i platformës eKosova prej vetëm 21% është dukshëm më i ulët. Rreth 94.6 % e komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptiane në Kosovë kanë telefon celular³⁰. Shumë Romë dhe Ashkali jetojnë në varfëri dhe përballen me një përjashtim të madh, ndër të tjera, paraqiten vështirësi në procedurat e regjistrimit civil. Deri në një e treta e Romëve nuk janë të regjistruar në lindje dhe nuk janë në gjendje të ushtrorjnë të drejtat dhe liritë e tyre për shkak të mungesës së regjistrimit civil. Kjo situatë prek ndjeshëm komunitetin në disa fusha, si mosregjistrimi i fëmijëve në shkollë, mospërfitimi nga programet e mirëqenies sociale, shërbimet e kujdesit shëndetësor, mundësitë e punësimit dhe të drejtat për pension. Shumica e anëtarëve të këtyre komuniteteve kanë nivele të ulëta të ndjekjes të arsimit³¹ dhe mund të mos kenë njohuri se çfarë mund të ofrojë shërbimi digjital dhe si të procedohet. Romët që nuk flasin shqip, mund të përballen me barriera të gjuhës në qasjen në shërbimet e eKosovës, për shkak të zbatimit jo të duhur të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve³².

²⁸ Raporti i Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Familje 2020

²⁹ NEVOJAT DHE MANGËSITË PËR AFTËSI DIGJITALE NË BALLKANIN PERËNDIMOR, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal 2021

³⁰ Anketa e grupeve me tregues të shumëfishtë në Kosovë* (UNSCR 1244) dhe Komunitetet Rome, Ashkali dhe Egjiptiane në Kosovë, Programi Global MICS

³¹ VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KOMUNITETI ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIANE TE KOSOVËS OSBE 2020

³² Perspektiva e të rinjve romë, ashkali dhe egjiptianë për mundësitë dhe sfidat e punës së denjë në Kosovë, ILO 2019

6 KUADRI I POLITIKËS, LIGJOR DHE RREGULLATOR

6.1 Hyrje

Ky seksion përshkruan instrumentet e mëposhtme ligjore dhe rregullatore, të rëndësishme në kontekstin e vlerësimit dhe menaxhimit të ndikimeve mjedisore dhe sociale të projektit:

- Politikat specifike të vendit, kornizat ligjore dhe administrative përkatëse për projektin;
- Standardet mjedisore dhe sociale të Bankës Botërore (ESS) përkatëse për projektin;
- Udhëzimet e Grupit të Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë (Udhëzimet MSHS) që lidhen me projektin; dhe
- Konventa të tjera ndërkombëtare dhe rajonale që janë miratuar nga Huamarrësi, si Konventa e Stokholmit për Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm, Konventa e Bazelit për mbetjet e rrezikshme dhe asgjësimin.

6.2 Politikat specifike të Kosovës, kornizat ligjore dhe administrative të zbatueshme për projektin

6.2.1 Legjislacioni Mjedisor

Dy institucione kryesore hartojnë, zbatojnë dhe mbikëqyrin zbatimin e legjislacionit dhe rregulloreve mjedisore në Kosovë: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK). MMPH-ja është organi qendror ekzekutiv, i ngarkuar për krijimin dhe zbatimin e legjislacionit të përgjithshëm të menaxhimit në fushën e mjedisit, ujit, planifikimit hapësinor të banesave dhe ndërtimit.

AMMK-ja është një institucion qeveritar që angazhohet, nëpërmjet monitorimit të integruar mjedisor, sistemit efikas të informacionit mjedisor dhe raportimit të vazhdueshëm të gjëndjes mjedisore, për ruajtjen e cilësisë së ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit, promovimin e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, për të siguruar një mjedis të shëndetshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm në harmoni me ecurinë e zhvillimeve ekonomike dhe sociale.

Ligji për mbrojtjen e mjedisit 2002/8 i ndryshuar me ligjin nr. 03/L-025. Qëllimi i ligjit është të promovojë krijimin e një mjedisi të shëndetshëm për popullsinë e Kosovës duke u përafuar gradualisht me standardet për mjedisin të Bashkimit Evropian³³. Qëllimi i ligjit është; shfrytëzimi racional i burimeve natyrore dhe kufizimi i shkarkimit të ndotjes në mjedis; parandalimi i dëmtimit; rehabilitimi dhe përmirësimi i kushteve mjedisore në lidhje me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve; rruajtjen dhe mirëmbajtjen e burimeve natyrore, të rinovueshme dhe jo të rinovueshme, si dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tyre; dhe koordinimin e aktiviteteve kombëtare për plotësimin e kërkesës për mbrojtjen e mjedisit. Ndotja e mjedisit dënohet me këtë ligj. Ligji i ngarkon MMPH-së përgjegjësinë për hartimin e masave administrative dhe sigurimin e qëndrueshmërisë mjedisore në Kosovë. Ai, gjithashtu i ngarkon komunat që të zbatojnë parimet bazë të mbrojtjes së mjedisit. Sipas nenit 29 të Ligjit, për Projektet që synojnë ndryshime teknologjike, rindërtim, zgjerim të kapaciteteve ose ndërprerje të punës dhe që mund të shkaktojnë rreziqe mjedisore ose për shëndetin e njeriut duhet të kryhet një Vlerësim i Ndikimit Mjedisor (VNM) dhe në MMPH duhet të dorëzohet një raport që përmbledh konkluzionet e atij Raporti të VNM-së, nëse një projekt apo punë e tillë ka potencial të konsiderueshëm për të shkaktuar Dëme Mjedisore. Sa i përket Projektit të Digjitalizimit të Kosovës, **aktivitetet e projektit nuk pritet të kenë ndikime të pakthyeshme mjedisore pasi projekti nuk parashikon punime të mëdha civile, por mund të financojë disa rinovime të objekteve ekzistuese (dhomat për pajisjet etj.), instalimin e software-ve dhe asnjë nga aktivitetet e tij nuk parashikohet të ketë një potencial të tillë për të shkaktuar dëme mjedisore dhe as nuk janë të listuara në Shtojcat I dhe II të Ligjit për të cilat VNM-ja do të ishte e detyrueshme ose opsionale.**

³³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2631>

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Nr. 03/L-214 i datës 2010) synon të parandalojë ose zbusë ndikimet negative të projekteve të propozuara dhe rregullon procedurat për identifikimin, vlerësimin, raportimin dhe administrimin e ndikimeve mjedisore të një projekti të propozuar, në mënyrë që gjatë procesit të vendimmarrjes nga MMPH për lëshimin e Pëlqimit Mjedisor të sigurojë që të gjitha informatat relevante lidhur me mjedisin janë ofruar dhe janë marrë parasysh. Një pëlqim mjedisor kërkohet për të gjithë projektet publike ose private të listuara në Shtojcën I ose Shtojcën II të këtij ligji, të cilët mund të kenë efekte të rëndësishme në mjedis për shkak të virtytit. Të gjitha projektet që janë të listuara në Shtojcën I do të jenë të detyruar t'i nënshtrohen VNM-së. Ndërkohë projektet e renditura në Shtojcën II do të shqyrtohen rast pas rasti dhe në përputhje me kriteret e shqyrtimit të përcaktuara në Shtojcën III (Karakteristikat e projekteve; Vendndodhja e projekteve; Karakteristikat e ndikimeve të mundshme), për të përcaktuar nëse ato duhet t'i nënshtrohen VNM-së. **Për llojet e aktiviteteve të planifikuara sipas këtij projekti, nuk ka gjasa që një VNM të kërkohet sipas legjislacionit kombëtar.**

Kosova nuk është palë në Konventën e Aarhusit për Qasjen në Informacion, Pjesëmarrje Publike në Vendimmarrje dhe Qasjen në Drejtësi për Çështjet Mjedisore (1998). Megjithatë, shumica e parimeve të Konventës zbatohen në legjislacionin kombëtar.

Ligji për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit (04/L-175) rregullon parimet, organizimin dhe mbikëqyrjen e inspektimit, koordinimin e mbikëqyrjes të inspektimit, të drejtat, detyrat, kompetencat e inspektorëve, të drejtat, detyrimet e subjekteve mbikëqyrëse, procedurën e kryerjes së inspektimit dhe çështje të tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e inspektimit. Fushëveprimi i këtij ligji ka të bëjë me detyrat dhe kompetencat e inspektorëve për mbikëqyrjen e fushave të mjedisit, ujit, natyrës, urbanistikës dhe ndërtimit brenda organeve të nivelit lokal dhe qendror, duke përfshirë Inspektoratin Komunal për Ndërtim dhe Inspektoratin Komunal për Mbrojtjen e Mjedisit.

Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit 2013–2022, synon të përmirësojë gjendjen aktuale të mjedisit dhe për brezat e ardhshëm dhe të rrisë ndërgjegjësimin për reduktimin e presioneve të ushtruara mbi burimet natyrore dhe mjedisin, si: ajri, uji, toka, natyra dhe trashëgimia kulturore dhe kështu me radhë. Ajo rekomandon një integrim të menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit në të gjithë sektorët e Kosovës. Objektivat e Strategjisë janë;

- Kompletimi i legjislacionit dhe harmonizimi me *acquis*-et e BE-së dhe zbatimi i tij;
- Integrimi i mbrojtjes së mjedisit në të gjithë sektorët, në mënyrë që të jetë pjesë e politikave dhe programeve të përgjithshme të zhvillimit (zhvillimit të sektorit);
- Reduktimi gradual i ndotjes së ajrit, ujit, tokës;
- Rritja e nivelit të menaxhimit të ujrave dhe mbeturinave;
- Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, mbrojtja e biodiversitetit dhe peizazheve natyrore;
- Rritja e njohurive dhe ndërgjegjësimit për çështjet mjedisore;

Qëllimi i *Liqjit për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102* është të shmangë, parandalojë ose zvogëlojë në bazë të prioriteteve efektet e dëmshme, duke përfshirë edhe bezdisjen, për shkak të ekspozimit ndaj zhurmës në mjedis. Kjo pjesë e legjislacionit ofron një bazë për zhvillimin e masave për të reduktuar gjenerimin e zhurmës nga burimet madhore, veçanërisht avionët e trafikut rrugor dhe trafiku hekurudhor, pajisjet e jashtme dhe ato industriale, makineritë e lëvizshme dhe për burime të tjera të ndotjes dhe shqetësimit akustik të mjedisit.

Udhëzimi Administrativ (UA) MMPH/01/2017 për Lëshimin e Lejes Mjedisore Komunale (LMK). Të gjitha projektet e listuara në Shtojcën e këtij UA duhet të jenë subjekt për LMK. **Për Projektin, parashikohen vetëm punime rinovimi dhe asnjë nga aktivitetet e propozuara për projektin nuk bie në Shtojcën e UA/MMPH/01/2017 të sipër përmendur.**

Ligji për Ndërtimin nr. 2004/2015 përcakton kërkesat kryesore për projektimin, ndërtimin dhe përdorimin e materialeve të ndërtimit, mbikëqyrjen profesionale, si dhe procedurat për lejet e ndërtimit, lejet e përdorimit dhe inspektimin e ndërtesave. Dispozitat e këtij ligji rregullojnë kushtet e projektimit dhe ndërtimit në lidhje me sigurinë publike dhe mbrojtjen e mjedisit në Kosovë, po ashtu ato zbatohen edhe për objektet tjera ndërtimore, përveç nëse me këtë ligj apo me udhëzim administrativ parashikohet ndryshe.

Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2013 Për Ndërtimet Për Të Cilat Nuk Kërkohet Leje Ndërtimi – Sipas këtij UA nuk kërkohet leje ndërtimi në rastet e rinovimit që janë në kuadër të ligjit për ndërtim, neni 3, paragrafi 1.11 - pa përfshirë ndryshimin e mureve mbajtëse, zëvendësimin ose zhvendosjen e tubacioneve ose kanalizimeve të ujit, instalimet elektrike që përfshijnë modifikimin e rrjeteve publike, çdo ndryshim në ngjyrën e llojit të materialit ose muraturës së përdorur.

6.2.2 Menaxhimi i Mbetjeve

Organi kryesor kombëtar me përgjegjësi për sektorin e menaxhimit të mbeturinave në vend është MMPH. Në nivel lokal, komunat kanë gjithashtu përgjegjësi të rëndësishme në drejtim të menaxhimit të mbeturinave. Megjithatë, përgjegjësitë në lidhje me grumbullimin e mbeturinave janë transferuar nga komunat tek "kompanitë rajonale të grumbullimit të mbetjeve". MMPH-ja lëshon lejet për menaxhimin e mbeturinave, lejet për eksport, import dhe transit të mbeturinave dhe menaxhon mbeturinat e rrezikshme. Për sa i përket licencave për menaxhimin e landfillit të mbetjeve, një ose disa bashki, me marrëveshje, mund të përcaktojnë dhe përdorin vendndodhjen në territorin e tyre për ndërtimin e objekteve dhe vendosjen e pajisjeve të menaxhimit të mbeturinave. Nëse komunat nuk arrijnë marrëveshje për vendosjen e një vendodhje të përbashkët për menaxhimin e mbeturinave, vendimi merret nga MMPH në bazë të plotësimit të kushteve sipas këtij ligji. Pushteti lokal (komunat) janë përgjegjëse për nxjerrjen e planeve lokale për menaxhimin e mbeturinave, përcaktimin e vendodhjes për nevojat e menaxhimit të mbeturinave komunale etj., sipas planit hapësinor, si dhe përcaktimin e tarifave për grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave komunale. Me ligj, ato janë përgjegjëse edhe për përzgjedhjen e personave të licencuar (përmes aplikimit të procedurave të prokurimit) për mbledhjen, grumbullimin, ruajtjen dhe transportimin e mbetjeve të ngurta, mbetjeve komunale, mbetjeve voluminoze nga ndërtimi dhe prishja e ndërtesave dhe objekteve tregtare brenda territorit të tyre. Mbeturinat e rrezikshme menaxhohen sipas dispozitave të Ligjit për Mbeturinat, përkatësisht MMPH-ja është e mandatuar të menaxhojë mbeturinat e rrezikshme, në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse.

Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë udhëhiqet nga *Ligji për Mbeturinat (Ligji Nr. 04/L-060, 2012)* dhe më shumë se 26 Udhëzime Administrative³⁴ që rregullojnë rrymat specifike të mbeturinave dhe aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave. Ligji për Mbeturinat mbulon aspektet teknike, operative, rregullatore dhe mjedisore të menaxhimit të integruar të mbeturinave në Kosovë. Ligji rregullon menaxhimin e mbeturinave komunale, mbeturinave të rrezikshme brenda Kosovës si dhe menaxhimin e mbeturinave specifike si; vajrat e përdorura dhe mbetjet me vajra; bateritë dhe akumulatorët e shpenzuar; mbeturinat e mbetjeve të etiketimit dhe paketimit; mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike; mbeturinat që përmbajnë PCB dhe PCT; mbeturinat nga prishja dhe ndërtimi i objekteve të ndërtesave ndër të tjera. Aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave të

³⁴ Midis të tjerave; UA nr. 03/2021 për Menaxhimin e Mbeturinave të Rrezikshme - i cili përcakton rregullat e grumbullimit, ndarjes, ruajtjes, transportit, trajtimit, ruajtjes dhe paketimit të mbetjeve të rrezikshme (mrr), detyrimet e prodhuesit, pronarit, transportuesit të mrr, si dhe kërkesat për aktivitetet gjatë trajtimit të mrr; UA nr. 25/2014 për menaxhimin e mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike dhe kufizimet në përdorimin e substancave të rrezikshme në pajisjet elektrike dhe elektronike, i cili përcakton dispozitat, detyrimet, kërkesat dhe kushtet e nevojshme për grumbullimin, ruajtjen, përpunimin, transportimin, ripërdorimin, trajtimin dhe asgjësimin e MPEE; UA nr.08/2017 për Menaxhimin e Landfilleve të Mbeturinave; UA nr.10/2011 për Parandalimin E Aksidenteve Sasiore që Përfshijnë Mbeturina Të Rrezikshme; UA nr.09/2010 për Licencën për Menaxhimin e Mbeturinave; UA Nr.05/2007 për Mbetjet nga Ndërtimi dhe Rrërimi i Objekteve; UA nr.02/07 për Mbeturinat nga Bateritë dhe Akumulatorët e Shpenzuar;

rregulluara me këtë ligj përfshijnë aktivitetet e grumbullimit, transportit, trajtimit, përpunimit, depozitimit, asgjësimit përfundimtar, importit dhe eksportit të mbeturinave.

Strategjia Kombëtare (2021-2030) dhe Plani i Veprimit (2021-2023) për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë (miratuar në 05/2021) është në fuqi. Midis 4 objektivave të strategjisë, Objektivit Specifik nr. 4.3 synon ngritjen e sistemeve për ripërdorim dhe riciklim dhe bazohet në konceptin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit. Sipas këtij objektiv do të krijohet një rrjet i qendrave të riciklimit në mbarë Kosovën. Sipas Strategjisë, për fraksione specifike të mbetjeve, si ambalazhet, gomat, automjetet e vjetra, bateritë dhe llojet e tjera të mbetjeve elektronike (MPEE), do të aplikohet parimi që "prodhuesit" do të përfshihen në organizimin dhe financimin e sistemeve të nevojshme për ripërdorimin, riciklimin dhe menaxhimin e materialeve pas konsumit. Një Udhëzim Administrativ është në fuqi për të filluar një Skemë të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuarit (PZP) për MPEE-të me objektiva për rritjen në mënyrë graduale të grumbullimit gjatë viteve të ardhshme. Përkundër faktit se Kosova nuk ka ratifikuar Konventat e Bazelit, Roterdamit dhe Stokholmit, QK-ja është e përkushtuar të zbatojë dispozitat e Konventave, duke përfshirë përmbushjen e kërkesave të raportimit në Sekretariatit e këtyre konventave.

Udhëzimi Administrativ 22/2015 i MMPH-se, përcakton se të gjitha mbeturinat që përmbajnë asbest duhet të largohen në përputhje me këtë UA.

6.2.3 Legjislacioni për Punën

Korniza ligjore e Kosovës që rregullon marrëdhënien e punës përbëhet nga *Ligji i Punës Nr. 03/L-212*. Ky ligj rregullon të drejtat dhe detyrimet që lindin nga marrëdhënia e punës. Ai siguron mbrojtje të veçantë për punonjësit në sektorin privat dhe publik. Gjithashtu mbron punëtorët e huaj dhe personat pa shtetësi të cilët janë të punësuar në territorin e Republikës së Kosovës. Ligji u jep mbrojtje të veçantë grave të punësuar, grave shtatzëna dhe/ose ato që ushqejnë me gji, punonjësve nën moshën 18 vjeç, si dhe punonjësve me aftësi të kufizuara.

Ligji Nr. 04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë ndjek shumicën e kërkesave të Direktivës Kuadër të BE-së 89/391/EEC. Ai përcakton masat për përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit të punonjësve në punë. Dispozitat e këtij ligji zbatohen në sektorin publik, privat dhe publiko-privat dhe në sektorin e administratës shtetërore në nivel qendror dhe lokal. Dispozitat e ligjit zbatohen edhe për praktikantët, nxënësit dhe studentët që kryejnë punë praktike gjatë shkollimit të tyre, personat në vuajtje të dënimit të angazhuar në punë, vizitorët, partnerët e biznesit, shfrytëzuesit e shërbimeve dhe personat që ndjekin aftësimin dhe rikualifikimin profesional tek punëdhënësi dhe për të gjithë punonjësit vendas dhe të huaj pavarësisht nga madhësia dhe statusi i tyre i punësimit. Ligji përmban parime të përgjithshme për parandalimin e rreziqeve në punë, eliminimin e faktorëve të rrezikshëm dhe të aksidenteve, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e ekuilibruar për përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë, trajtimin e punonjësve, përfaqësuesve të tyre dhe udhëzime të përgjithshme për zbatimin e këtyre parimeve, dhe përcakton edhe punëdhënësin. Ligji do të zbatohet plotësisht gjatë zbatimit të aktiviteteve të propozuara.

Ligjet dhe politikat e Kosovës për punën (kriteret dhe kushtet) dhe shëndetin dhe sigurinë në punë janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, përkatësisht Konventat e ILO-s dhe Direktivat e BE-së, dhe po ashtu kriteret, kushtet dhe instrumentet e propozuara në konventat dhe direktivat ndërkombëtare janë të inkuorpuara në legjislacionin kombëtar të punës. Përgjegjësitë kryesore për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë (SHSP) i janë dhënë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transferave (MFPT) dhe Inspektoratit të Punës.

6.2.4 Qeverisja e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit

Në vitet e fundit, Qeveria e Kosovës (QK) i ka dhënë prioritet reformave të administratës publike për të transformuar sektorin e saj publik në një administratë më moderne, më efiçiente dhe me në qendër qytetarin, dhe ka mbështetur përdorimin e Teknologjisë të Informacionit (TI) në ofrimin e shërbimeve publike. Në bashkëpunim me BE-në, QK-ja miratoi Strategjinë e Reformës së Administratës Publike (2015-2020), e cila ofroi orientimin kryesor strategjik të Qeverisë në këtë fushë.

Strategjia e re e Qeverisjes Elektronike 2023-2027 thekson rëndësinë e investimeve në infrastrukturën digjitale dhe qeverisjen digjitale për të përmirësuar lidhjen brenda qeverisë dhe për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve qeveri-qytetar, si dhe për të mbështetur më mirë ndërveprimet qeveri-biznes.

Miratimi i Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike (SKSK) 2016-2019 dhe themelimi i Këshillit Kombëtar të Sigurisë Kibernetike (KKSK) dhe i një njësie kombëtare për reagimin ndaj sulmeve kibernetike të Kosovës (KOS-CERT) ishin përparime të mëdha gjatë pesë viteve të fundit.

Draft Agjenda Digjitale e Kosovës 2030 përcakton prioritetet e Kosovës në kontekstin e transformimit të vazhdueshëm digjital të ekonomisë dhe shoqërisë, të influencuara nga teknologjitë inovative dhe trendet digjitale globale.

Një grup i plotë ligjesh dhe rregulloresh janë miratuar nga Kosova në lidhje me dokumentacionin elektronik, nënshkrimin elektronik, mbrojtjen e të dhënave, sigurinë kibernetike për të dhënat personale në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rregulloret e BE-së. Këtu përshihen:

- Ligji për Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit (Ligji Nr. 04/L-094, Kapitulli 1, Neni 1. 15 mars 2012), i cili njeh dokumentet elektronike si ligjërisht të barasvlershme me dokumentet e bazuara në letër,
- Ligji për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Mirëbesimit në Transaksionet Elektronike (Ligji Nr. 08/L -022, 6 dhjetor 2021), i cili zbatohet për skemat e identifikimit elektronik dhe për ofruesit e shërbimeve të besuara për transaksionet elektronike;
- Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Ligji nr. 06/L-082³⁵, 30 janar 2019), i cili mbulon të gjitha fushat kryesore të mbrojtjes së të dhënave, duke përfshirë kërkesat gjithëpërfshirëse të sigurisë kibernetike dhe është në përputhje me Rregulloren e BE-së 2016/679 për mbrojtjen e personave fizik në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale dhe qarkullimin e lirë të këtyre të dhënave;
- Ligji për Qasje në Dokumentet Publike³⁶;
- Ligji për Komunikimin Elektronik nr. 04/L-109³⁷;
- Rregullorja për Standardet Minimale të Konsultimit Publik³⁸;

Për shkak të çështjeve që kanë të bëjnë me statusin, Kosova nuk është palë e instrumentit kryesor ndërkombëtar për luftën kundër krimit kibernetik – Konventa për Krimin Kibernetik e Këshillit të Evropës (CETS nr. 185), por ka transpozuar dispozitat përkatëse të saj. Të gjithë komponentët thelbësorë të Konventës së Budapestit janë kodifikuar në legjislacionin e Kosovës për krimin kibernetik³⁹, i cili në përgjithësi është në përputhje me acquis të BE-së.

³⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18616>

³⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20505>

³⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2851>

³⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15036>

³⁹ Ligji nr. 03/L-166, 2010 për Parandalimin dhe Luftën ndaj Krimit Kibernetik

Më 14 shtator 2022, Qeveria e Kosovës miratoi projektligjin për Sigurinë Kibernetike, përmes të cilit u themelua Agjencia për Sigurine Kibernetike. Ligji synon të përcaktojë parimet e sigurisë kibernetike për institucionet që zhvillojnë dhe zbatojnë politikën e sigurisë kibernetike, përgjegjësitë e autoriteteve në fushën e sigurisë kibernetike, detyrat e subjekteve, bashkëpunimin ndërinstytucional dhe masat për parandalimin e sulmeve kibernetike në Republikën e Kosovës.

6.3 Politikat dhe Standardet Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore

6.3.1 Standardet e KMS-së përkatës për projektin

Bazuar në Standardet Mjedisore dhe Sociale (ESS) të BB-së, rreziqet e përgjithshme të projektit klasifikohen si Mesatare⁴⁰. Pesë nga dhjetë Standardet Mjedisore dhe Sociale (ESS) të KMS-së të Bankës Botërore janë shqyrtuar si relevante. Ato janë vlerësuar në Tabela 6-1 më poshtë.

ESS-të e tjera të konsideruara si jo relevante, përfshijnë: ESS5 - Blerja e Tokës, Kufizimet në Përdorimin e Tokës dhe Zhvendosjen e Pavullnetshme; ESS6 - Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve të Gjalla Natyrore; ESS7 - Popujt Indigjenë/Komunitetet Lokale Tradicionale Historikisht të Pashërbyera; ESS8 – Trashëgimia Kulturore; dhe ESS9 - Ndërmjetësuesit Financiar.

Tabela 6-1 Veprimet e kërkuara të Standardeve Mjedisore dhe Sociale të Projektit

Standardet Mjedisore dhe Sociale	Masat dhe Veprimet e kërkuara
ESS1 Vlerësimi dhe Menaxhimi i Rreziqeve dhe Ndikimeve Mjedisore dhe Sociale	I Aplikueshëm Projekti pritet të përmirësojë aksesin e qytetarëve në shërbimet publike dhe ndërveprimin e tyre me qeverinë përmes investimeve për transformimin digjital të qeverisë dhe transformimin digjital të shërbimeve publike. Aktivitetet e projektit mund të paraqesin gjithashtu rreziqe mesatare negative mjedisore, sociale, të shëndetit dhe të sigurisë nga punimet civile në shkallë të vogël (rinovimi i objekteve ekzistuese, dhomat për pajisjet) gjenerim të mbetjeve (përfshirë mbetjet e ndërtimit dhe mbetjet elektronike gjatë operimit të akumuluarave gjatë viteve), konsum të energjisë, pabarazi në aksesin e shërbimeve digjitale, veçanërisht për grupet vulnerabël dhe rrezik të humbjes së të dhënave dhe/ose keqpërdorimit të të dhënave. Ky Plan i përgjithshëm i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) adreson kërkesat e ESS1 dhe është subjekt për konsultim me palët e interesuara qeveritare dhe joqeveritare gjatë përgatitjes, duke pasuar PAPI-in e përgatitur për Projektin. QK-ja do të vlerësojë dhe menaxhojë rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale që lidhen me aktivitetet e propozuara të projektit në mënyrë proporcionale me shkallën e rëndësisë të rreziqeve dhe ndikimeve të mundshme, dhe e cila përdor një qasje hierarkike zbutëse gjatë përgatitjes së projektit.
ESS2 Puna dhe Kushtet e Punësimit	I Aplikueshëm Projekti do të ketë punonjës të drejtpërdrejtë, kontraktorë ((punonjës në kompanitë konsulente të punësuar për Asistencën Teknike dhe ndoshta punëtorë ndërtimi për punimet e vogla të rehabilitimit), nëpunës civilë të qeverisë (nëpunës civilë ekzistues dhe të rinj) dhe punëtorë të furnitoreve kryesorë (për pajisjet elektrike dhe elektronike). Kërkesat e ESS2 do të instruktohen përmes PMMS-së të projektit, dokumentave të ofertës, kontratave dhe marrëveshjeve. Projekti do të zbatojë Procedurat e Menaxhimit të Punës (PMP) të cilat përcaktojnë mënyrat sipas të cilave punëtorët e projektit do të menaxhohen, si dhe masat për të minimizuar rreziqet e mundshme të punës që lindin gjatë zbatimit. PMP të Projektit përcaktojnë gjithashtu kërkesat, standardet, politikat dhe procedurat,

⁴⁰ Siç përcaktohet në Përmbledhjen e Konceptit të Shqyrtimit Mjedisor dhe Social (ESRS).

	dhe përfshijne mekanizëm funksional të ankesave për ankesat që lindin gjatë punësimit, duke u mbështetur në ligjet dhe rregulloret kombëtare, si dhe ESS2 për të menaxhuar ankesat në lidhje me punësimin. PMP do të përfshijë dispozita për të siguruar të gjithë kontraktorët kanë zbatuar një Kod Sjelljeje që adreson SHAS/NS.
ESS3 Efienca e Burimeve dhe Parandalimi dhe Menaxhimi i Ndotjes	I Aplikueshëm Projekti mund të rezultojë në rreziqe të vogla nga ndotja si rrjedhojë e punimeve të ndërtimit në shkallë të vogël, të çojë në një rritje të rrymes së mbeturinave elektronike dhe rritje të përdorimit të energjisë nga përdorimi i gjeneratorëve rezervë të energjisë, dhe përdorimi i sistemeve të ftohjes dhe sistemeve të shuarjes së zjarrit. Ndikimet tipike të lidhura me rinovimin e zyrave, si; pluhuri, ndotja e ajrit, gjenerimi i mbetjeve dhe rreziqet për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve, do të trajtohen duke zbatuar masat e specifikuar në këtë PMMS. PMMS e pergjithshme do të përfshijë procedurat dhe masat e duhura për menaxhimin e mbeturinave elektronike dhe për përdorimin efikas të burimeve.
ESS4 Shëndeti dhe Siguria e Komunitetit	I Aplikueshëm PMMS-ja përfshin dispozita për menaxhimin e duhur të mbetjeve/ mbeturinave elektronike, duke përfshirë menaxhimin e venddepozitimeve të përdorura potencialisht nga Projekti, rrethimin e venddepozitimeve si dhe ndalimin e punës të fëmijëve dhe punës së detyruar. Ekspozimi i komunitetit ndaj zhurmës dhe pluhurit do të jetë i papërfillshëm pasi aktivitetet e propozuara rinovuese do të kryhen brenda ambienteve ekzistuese dhe nuk parashikohen rreziqe për shëndetin dhe sigurinë e komunitetit nga këto aktivitete. Çështjet e aksesit të qeverisjes digjitale do të menaxhohen nëpërmjet identifikimit të grupeve në rrezik përjashtimi gjatë përgatitjes së projektit dhe angazhimit efikas të palëve të interesuara gjatë zbatimit. Dizajni i masave të privatësisë dhe sigurisë do të ndjekë praktikën më të mirë.
ESS5 Blerja e tokës, Kufizimet në Përdorimin e Tokës dhe Zhvendosja e Pavullnetshme	Jo i Aplikueshëm
ESS6 Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve të Gjalla Natyrore	Jo i Aplikueshëm
ESS7 Popujt Indigjenë/Komunitetet lokale tradicionale të nënshërbyera Historikisht në Afrikën Sub-Sahariane	Jo i Aplikueshëm
ESS8 Trashëgimia Kulturore	Jo i Aplikueshëm
ESS9 Ndërmjetësuesit financiarë	Jo i Aplikueshëm
ESS10 Angazhimi i Palëve të Interesuara dhe Bërja Publike e Informacionit	I Aplikueshëm PAPI është përgatitur dhe Mekanizmi i Shyrtimit/Zgjidhjes të Ankesave të Projektit (MZA) do të zbatohet siç përcaktohet në këtë PMMS. ASHI do të bëjë publik dhe miratojë PAPI përpara vlerësimit të projektit dhe do të zbatojë PAPI-in gjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit. ASHI do të zhvillojë dhe zbatojë Mekanizmin e Zgjidhjes të Ankesave (MZA) përpara fillimit të aktiviteteve të projektit ose brenda 30 ditëve nga data e fillimit të aktiviteteve të Projektit dhe më pas do ta zbatojë atë gjatë gjithë ciklit të zbatimit të projektit.

6.3.2 Udhëzuesit për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë te Grupit të Bankës Botërore (Udhëzimet MSHS)

Udhëzuesit për MSHS-në e Grupit të Bankës Botërore përfaqësojnë praktikën e mirë ndërkombëtare për menaxhimin e rreziqeve mjedisore, sociale dhe të komunitetit/të shëndetit dhe sigurisë në punë gjatë hartimit dhe zbatimit të projektit. Udhëzuesit MSHS gjithashtu përshkruajnë nivelet e performancës dhe masat për zhvillimin, ndërtimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të objekteve dhe përdorimin e teknologjive më të fundit me kosto të arsyeshme.

Kur rregulloret e vendit pritës ndryshojnë nga masat e paraqitura në Udhëzuesit MSHS, projektet pritëse të arrijnë cilado që është më strikte.

Udhëzime të përgjithshme të MSHS-së

Udhëzuesi 1.0 - Mjedisi

Udhëzuesi i Përgjithshëm Mjedisor (MSHS) ofron metoda të qasjes për menaxhimin e ujërave të zeza, zhurmës dhe pluhurit gjatë ndërtimit, ruajtjes burimeve të ujit dhe menaxhimit të mbetjeve të ngurta.

Udhëzuesi 2.0 - Shëndeti dhe Siguria në Punë

Kushti themelor për SHSP-në sipas Udhëzuesve të MSHS-së është se "*Punëdhënësit dhe mbikëqyrësit janë të detyruar të zbatojnë të gjitha masat paraprake të arsyeshme për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve*" dhe se "*Kompanitë duhet të punësojnë kontraktorë që kanë aftësi teknike për të menaxhuar çështjet e shëndetit dhe sigurisë në punë për punonjësit e tyre*".

Udhëzuesit e MSHS-së kërkojnë gjithashtu që masat e parandalimit dhe të kontrollit për të minimizuar rreziqet në punë duhet të bazohen në analizat gjithëpërfshirëse të sigurisë në punë (ASP). Nëse është e nevojshme, Këshilluesi i Sigurisë i Njesisë Qëndrore të Zbatimit (NjQZ) do të ndihmojë kontraktorin në ndërmarrjen e ASP-së dhe përgatitjen e Planit të tij të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë bazuar në parimet e mëposhtme të hierarkisë së zbutjes:

- Eliminimin e rrezikut duke larguar procesin e punës të aktivitetit;
- Kontrollin e rrezikut në burimin e tij nëpërmjet përdorimit të kontrolleve inxhinierike
- Minimizimin e rrezikut nëpërmjet projektimit të sistemeve të sigurta të punës dhe masave të kontrollit administrative ose institucionale; dhe
- Sigurimin e pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse personale (PMP) në lidhje me trajnimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e PMP-ve.

Udhëzuesi 3.0 - Shëndeti dhe Siguria e Komunitetit

Ky udhëzues ofron qasje dhe metoda për cilësinë e ujit të pijshëm, jetën dhe sigurinë nga zjarri për projektimin e ndërtesave dhe projektimin strukturor të ndërtesave. Disa udhëzime mund të jenë të dobishme për ndërtimin dhe rinovimin e ndërtesave të reja, në lidhje me sigurinë e trafikut (transportin e materialeve) dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse nga puna e importuar.

Udhëzuesi 4.0 - Ndërtimi dhe Çmontimi

Udhëzuesi i MSHS-së për Ndërtimin dhe Çmontimin ofron udhëzime për çështje të veçanta të komunitetit dhe të shëndetit dhe sigurisë në punë dhe mjedisit në lidhje me ndërtimet e reja ose rinovimin e ndërtesave.

Udhëzuesit e MSHS-së për Telekomunikacionin

Udhëzimet e MSHS-së për Telekomunikacionin të BB-se janë të zbatueshme për infrastrukturën e telekomunikacionit të tilla; si infrastruktura e transmetimit të të dhënave, zërit nrm valëve dhe nëpërmjet linjave fikse, duke përfshirë kabllot tokësore dhe nënujore në distanca të gjata (p.sh. kabllot me fibra optike), si dhe transmetimet radio dhe televizive dhe instalimet dhe pajisjet e telekomunikacionit dhe transmetimit të lidhura me to.

Tabela e mëposhtme paraqet një vlerësim të Udhëzimeve të MSHS-së për Telekomunikacionin të BB-së kundrejt aktiviteteve të propozuara në kuadër të Projektit të Qeverisjes Digjitale të Kosovës.

Tabela 6-2 Vlerësimi i projektit kundrejt Udhëzuesit të MSHS-së për Telekomunikacionin të BB

Elementët e Udhëzuesit MSHS të Telekomunikacionit të BB-së	Përshatshmëria me Projektin e Qeverisjes Digjitale të Kosovës
Environment	
<ul style="list-style-type: none"> Ndryshim i habitatit tokësor Përplasjet e shpendëve Ndryshimi i habitatit ujor Ndryshimi i habitatit detar Ndikimet Vizuale 	Projekti nuk do të financojë rehabilitimin apo ndërtimin e infrastrukturës së re. Objekti backup (Qendra DRC) do të vendoset ne Deçan, duke përdorur një objekt ekzistues të pashfrytëzuar, dhe QSHI ne Prishtine do të vendoset në një vendodhje ekzistuese qeveritare. Nuk pritet asnjë ndikim negativ në habitatet tokësore detare ose ujore ose sjelljen e shpendëve dhe ndikimet vizuale.
<ul style="list-style-type: none"> Materialet e rrezikshme dhe mbeturinat 	Aktivitetet e propozuara nuk do të përfshijnë përdorimin e materialeve të rrezikshme (vetëm sasi të vogla karburanti për përdorimin e gjeneratorëve rezervë të energjisë) Aktivitetet e funksionimit dhe mirëmbajtjes do të kenë potencialin për gjenerimin e mbetjeve elektronike (p.sh. bateritë nikel-kadmium dhe pllaka e qarkut të kompjuterit dhe pajisjeve të tjera elektronike, si dhe bateritë rezervë të energjisë). Funksionimi i gjeneratorëve rezervë mund të rezultojë gjithashtu në gjenerimin e vajrave të përdorur dhe filtrave të përdorur.
<ul style="list-style-type: none"> Fushat elektrike dhe magnetike (EMF) Emetimet ne ajer 	Pajisjet me fibër optike nuk emetojnë EMF. Të dhënat për rreziqet negative shëndetësore nga EMF nga 4G dhe teknologji të tjera celulare janë të dobëta. Emetimet nga projektet e telekomunikacionit mund të lidhen kryesisht me operimin e automjeteve, përdorimin e gjeneratorëve rezervë të energjisë dhe përdorimin e sistemeve të ftohjes dhe shuarjes së zjarrit. Këto çështje nuk kanë lidhje me shkallën dhe shtrirjen e aktiviteteve të Projektit.
<ul style="list-style-type: none"> Zhurmat 	Burimi kryesor i zhurmës në objektet e telekomunikacionit është i lidhur me funksionimin e gjeneratorëve rezervë të energjisë. Aktivitetet e Projektit të Digjitalizimit të Kosovës (punimet e rinovimit) do të zhvillohen brenda ndërtesave ekzistuese dhe do të mbështeten në infrastrukturën ekzistuese dhe gjeneratorët rezervë të energjisë elektrike do të përdoren vetëm me ndërprerje dhe do të kenë një emetim relativisht të ulët të zhurmës në një kontekst urban.
Shëndeti dhe Siguria në Punë <ul style="list-style-type: none"> Siguria Elektrike Ndërtimi 	Adresuar në Kapitullin Error! Reference source not found. të këtij PMMS
Shëndeti dhe Siguria e Komunitetit	Adresuar në Kapitullin Error! Reference source not found. të këtij PMMS

7 NDIKIMET POTENCIALE MJEDISORE DHE SOCIALE

7.1 Planifikimi/Projektimi

Punimet civile në shkallë të vogël, veçanërisht krijimi i DRC-se dhe QSHI-se do të bëhet brenda objekteve/vendodhjeve ekzistuese qeveritare. Nuk do të jetë e nevojshme blerja e pavullnetshme e tokës dhe aksesi i tokës; Instalimi ose përmirësimi i pajisjeve të rrjetit për të përmirësuar shërbimin do të bëhet në ndërtesa tashmë të përdorura ose të operuara nga qeveria.

7.1.1 Shëndeti dhe Siguria në Dizajnin e Projektit

Menaxhimi efikas i çështjeve të shëndetit dhe sigurisë kërkon përfshirjen e konsideratave të shëndetit dhe sigurisë gjatë proceseve të dizajnit në një mënyrë të organizuar, hierarkike që përfshin hapat e mëposhtëm:

- identifikimin e rreziqeve të projektit për shëndetin dhe sigurinë dhe rreziqet shoqëruese sa më shpejt që të jetë e mundur në ciklin e projektit, duke përfshirë dhe integruar konsideratat e shëndetit dhe sigurisë në procesin e përzgjedhjes së vendit të punës dhe metodologjitë e ndërtimit;
- përfshirjen e profesionistëve të shëndetit dhe sigurisë të cilët kanë përvojën, kompetencën dhe trajnimin e nevojshëm për të vlerësuar dhe menaxhuar rreziqet e shëndetit dhe sigurisë;
- të kuptuarit e propabilitetit dhe madhësisë së rreziqeve për shëndetin dhe sigurinë, bazuar në:
 - natyrën e aktiviteteve të projektit, të tilla si; nëse projekti do të përfshijë materiale ose procese të rrezikshme;
 - pasojat e mundshme për punëtorët nëse rreziqet nuk menaxhohen në mënyrë adekuate;
 - projektimin dhe zbatimin e strategjive të menaxhimit të rrezikut me objektiv reduktimin e rrezikut për shëndetin e njeriut;
 - prioritizimin e strategjive që eliminojnë shkakun e rrezikut në burimin e tij duke përzgjedhur materiale ose procese më pak të rrezikshme që shmangin nevojën për kontrolle të shëndetit dhe sigurisë;
 - kur shmangia e ndikimit nuk është e realizueshme, duke përfshirë kontrollet inxhinierike dhe menaxhuese për të reduktuar ose minimizuar mundësinë dhe madhësinë e pasojave të padëshiruara;
 - përgatitjen e punëtorëve dhe komuniteteve aty pranë për të reaguar ndaj aksidenteve, duke përfshirë sigurimin e burimeve teknike për të kontrolluar në mënyrë efektive dhe të sigurt ngjarje të tilla; dhe
 - Përmirësimin e performancës së shëndetit dhe sigurisë nëpërmjet një kombinimi të monitorimit të vazhdueshëm të performancës së objektit dhe llogaridhënies efektive.

Duke pasur parasysh rrjetet e mëdha të kabllove dhe pajisjeve elektronike të përdorura në DRC, ekziston një rrezik potencial për zjarre elektrike. Zjarret e qendrës së të dhënave mund të ndërpresin ndjeshëm shërbimin e komunikimit dhe të kenë ndikim negativ të pamatshëm në besimin e konsumatorit për shërbimin, pasi kjo mund të përfundojë në humbjen e të gjitha të dhënave. Edhe kur të dhënat ruhen në vendodhje të tjera cloud, zëvendësimi i hardware-it të dëmtuar dhe infrastrukturës tjetër në një qendër të dhënash të prekur nga zjarri mund të jetë shumë i shtrenjtë.

Përpara se të vendoset për llojin e sistemit që kërkohet për të mbrojtur një qendër të dhënash, është e rëndësishme të kryet një analizë rreziku për të kuptuar nevojat e organizatës, mjedisit dhe rreziqet kryesore. Ekzistojnë konsiderata të ndryshme për krijimin dhe menaxhimin e qendrave të të dhënave dhe për sigurinë e punonjësve dhe mënyrat për të mbrojtur qendrën e të dhënave nga zjarri, si p.sh. Shuarja e Zjarrit me Mjete të

Pastra (Clean Agent) dhe Shuarja e Zjarrit nga Mjegulla e Ujit⁴¹. Lloji i parë i sistemit të shuarjes së zjarrit përfshin agjentë të pastër miqësorë me mjedisin, siç janë gazrat inertë të cilët tashmë janë natyrshëm pjesë e atmosferës dhe nuk kontribuojnë në shterimin e shtresës së ozonit. Sistemi i mjegullës së ujit përdor pikat e ujit të atomizuar për shuarjen e zjarreve për shkak të efektit të tyre të ftohjes dhe bllokimit të nxehtësisë rrezatuese, avullon më shpejt duke rezultuar në shumë më pak ujë të nevojshëm për të shuar zjarrin sesa sistemet tradicionale të spërkatjes ose mjegullës me presion të ulët.

7.2 Faza e Ndërtimit

7.2.1 Rreziqet Mjedisore

Rreziqet mjedisore lidhen me punimet civile në shkallë të vogël të parashikuara në nënkomponentin 1.2 dhe nënkomponentin 2.2 për shkak të rinovimit të objekteve ekzistuese (dhoma për pajisjet etj.) për krijimin e DRC-së, QSHI-së dhe Qendrës së Kontaktit. Këto aktivitete ka gjasa të mund të rezultojnë në ndikime afatshkurtra, lokale dhe të kthyeshme, si p.sh.

- Emetimet e pluhurit dhe zhurmës nga transporti i punëtorëve dhe materialeve, ngarkimi dhe shkarkimi i materialeve, suvasë, izolimit dhe elementëve të tjerë të ndërtimit
- Gjenerimi i mbeturinave - sasi e vogël e mbetjeve ndërtimore do të krijohet kryesisht gjatë rinovimit/mobilimit të ambjentëve.
- Ndikimet në tokë do të jenë shumë të kufizuara, megjithatë, janë të mundshme disa derdhje dhe rrjedhje të karburantit, vajrave, bojës etj.

Përveç punimeve të rinovimit, rrjeti i ri dhe pajisjet e lidhura me to ka të ngjarë të gjenerojnë mbetje elektronike nga komponentët e tepërt të TIK-ut, të cilat mund të kenë ndikime mjedisore për shkak të rritjes së sasisë së gjenerimit të mbetjeve elektronike. Mos menaxhimi i duhur i mbeturinave elektronike mund të ndikojë në mjedis për një periudhë të gjatë për shkak të shkarkimeve të acideve dhe metaleve të rënda nga bateritë). Këto mund të arrijnë në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe të prekin shëndetin e njerëzve, kafshët, të korrat etj.

7.2.2 Rreziqet Sociale

Shëndeti dhe Siguria në Punë

Krijimi i DRC-së, QSHI-së dhe Qendrës së Kontaktit do të paraqesin rreziqe të ulëta të sigurisë për punëtorët gjatë kryerjes të punëve elektrike, dhe rrjedhimisht rrezik të ulët nga goditjet elektrike dhe djegiet e harkut për shkak të instalimit të pajisjeve hardware-ve, pajisjeve të rrjetit. Përfundimi i punimeve civile në shkallë të vogël si rrjedhojë e punimeve të rinovimit brenda ndërtesës ekzistuese mund të rezultojë në rreziqe të ulëta për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve, megjithatë do të zbatohen masat të përshtatshme të shëndetit dhe sigurisë në punë. Ata punëtorë që merren me transportin e pajisjeve për DRC-në mund të përballen me rrezik për aksidente/lëndime kur merren me pajisje të rënda. Lidhjet elektrike duhet të kryhen nga një elektrikist i kualifikuar. Rreziqet e SHSP-së do të menaxhohen duke ndjekur procedura strikte për çaktivizimin dhe kontrollin e pajisjeve elektrike për të minimizuar efektet e rrezikshme. Gjithashtu, udhëzimet e sigurisë duke përfshirë; standardet e sigurisë ndaj energjisë elektrike për pajisjet dhe personelin; standardet e sigurisë së diegies të harkut elektrik; kufijtë fizikë për punën në sistemet elektrike; standardet e ruajtjes nga zjarri dhe të ruajtjes së mjedisit për bateritë e rikarikueshme; Standardet e sistemit të shuarjes së zjarrit duhet të vendosen dhe të zbatohen. Ekspozimi i punëtorëve gjatë çmontimit dhe diferencimit të mbetjeve elektronike, mund të ndikohet seriozisht nëse nuk do të zbatohen masat e sigurisë. Ekziston një mundësi e vogël që materiale që përmbajnë

⁴¹ <https://dataspan.com/blog/everything-you-need-to-know-about-data-center-fire-suppression/>

azbest mund të ndeshen gjatë instalimeve/punimeve në ndërtesat qeveritare⁴², çka mund të çojë në rreziqe të SHSP-së dhe sasi të vogla të mbetjeve që përmbajnë asbest.

Rreziqet e shëndetit dhe sigurisë së komunitetit

Ndikimet në shëndetin dhe sigurinë e komunitetit si nga kryerja e punimeve të vogla civile (p.sh. pluhuri, zhurma) do të jenë të papërfillshme, pasi punimet do të kryhen brenda ndërtesave ekzistuese.

Probabiliteti i ndodhës së punës së fëmijëve ose punës së detyruar është gjithashtu minimal, i papërfillshëm dhe menaxhohet nëpërmjet legjislacionit kombëtar. Projekti kërkon staf teknik me aftësi që kërkojnë përvojë dhe edukim, gjë që nuk do të jetë e mundur për fëmijët ose ata nën moshën 18 vjeç. Projekti pritet të ketë ndikime të papërfillshme negative në lidhje me SHAS/NS gjatë ndërtimit, pasi nuk parashikohen punime të mëdha civile dhe do të nevojitet një numër i vogël i punëtorëve të ndërtimit. Punimet civile në shkallë të vogël do të zhvillohen brenda objekteve ekzistuese dhe në zonat urbane të Prishtinës dhe qytetit të Deçanit ku qasja në shërbimet shëndetësore dhe mbështetje të specialistëve është më e madhe. Megjithatë, PMP-ja përfshin dispozita për të siguruar që të gjithë kontraktorët (ata të angazhuar për instalimin e pajisjeve ose kryerjen e aktiviteteve të mirëmbajtjes dhe të tjerët të kontraktuar për punime rinovimi) të kenë një Kod Sjelljeje përpara se të hyjë në fuqi zbatimi I Projektit dhe të gjithë punëtorët do të informohen për Kodin e Sjelljes së Projektit përpara nënshkrimit të kontratës. Kanalet për raportimin e çdo abuzimi të dyshuar janë gjithashtu të përshkruara në PMP. PMMS-ja e Kontraktorit do të përfshijë masat e duhura të menaxhimit dhe të zbatjes.

Pavarësisht se rastet aktive me COVID-19 janë të rralla (1 deri në 7 raste të reja për Nëntorin në Kosovë), aktivitetet e projektit do të zbatohen në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet kombëtare të sigurisë ndaj COVID-19 dhe udhëzimet e Bankës Botërore për COVID-19, për punimet e ndërtimit dhe punimet civile për të parandaluar përhapjen e COVID-19.

7.3 Faza e Operimit

7.3.1 Përfitimet Mjedisore

Projekti i Qeverisjes Digjitale të Kosovës dhe zhvillimi i TIK-ut do të kenë përfitime mjedisore me efekte indirekte, të cilat përfshijnë si më poshtë;

- Ulje të mbishfrytëzimit të burimeve natyrore për përdorim të energjisë nga teknologjitë e prodhimit të letrës, transportit,
- Reduktim të emetimeve të CO₂ (reduktim i gjenerimit të CO₂ nga teknologjitë e prodhimit të letrës, transportit etj.)
- Reduktim i shpyllëzimit pasi njerëzit do të ulin varësinë nga kopjet në letër duke përdorur kopje të lexueshme në kompjuter (kopje digjitale) dhe transferim informacioni përmes internetit
- Reduktim i emetimeve të gazeve serrë dhe optimizimi i kostos duke përdorur pajisje TIK 'te gjelbra' dhe duke kontribuar kështu në zbatjen e ndryshimeve klimatike.

7.3.2 Rreziqet Mjedisore

Gjatë fazës së funksionimit mund të ketë ndikime që lidhen me akumulimin ndër vite të mbeturinave elektronike si rrjedhojë e fundit të jetës të pajisjeve, fuqisë së baterive dhe gjenerimi i mbetjeve elektronike nga institucionet që do të lidhen me platformat digjitale. Gjithashtu, menaxhimi i dobët i mbetjeve elektronike mund të çojë në ndotjen e ajrit, tokës dhe ujit dhe të ndikojë në shëndetin e njeriut, në biodiversitet për shkak të çlirimit të

⁴² Sipas dokumentit mbi Sigurinë nga ekspozimi ndaj asbestit në Kosovë 2016, shumica e komplekseve industriale dhe ndërtesave në Kosovë të ndërtuara 50-60 vjet më parë përmbanin gamë të lartë të materialit të asbestit.

kimikateve toksike. Një sërë metalesh të rënda janë përbërës të pjesëve të kompjuterave, printerëve, etj. Ndotja në ajër ndodh kur mbetjet elektronike asgjësohen në mënyrë informale duke çmontuar, copëtuar ose shkrirë materialet, duke çliruar në mjedis grimca pluhuri ose toksina, të tilla si dioksina që shkaktojnë ndotjen e ajrit dhe si rrjedhojë dëmtojnë rrugët e frymëmarrjes. Efektet negative në ajër nga riciklimi jo i duhur i mbetjeve elektronike janë më të rrezikshmet për ata që merren me këtë proces, por ndotja mund të shtrihet edhe në zonat përreth. Asgjesimi jo i duhur i mbeturinave elektronike në landfillet e rregullta ose në vendet ku ato hidhen ilegalisht mund të depërtojnë drejtpërdrejt në tokë, duke shkaktuar ndotje të ujërave nëntokësore me metale të rënda (si zhiva, litiumi, plumbi dhe bariumi) dhe kontaminim të kulturave që mbillen aty afër ose në zonë në të ardhmen. Komponentë të tillë toksikë (metalet e rënda) mund të shkaktojnë acidifikimin dhe toksicitetin në ujë, cka mund të jetë e rrezikshme për kafshët, bimët dhe shëndetin e njeriut.

Sistemi rezervë i energjisë pritet të jetë një gjenerator me naftë i cili do të gjenerojë një sasi të vogël emetimesh (ndotje të ajrit dhe zhurmës), pasi do të përdoret me ndërprerje.

Projekti mund të rezultojë gjithashtu në një rritje të lehtë të përdorimit të energjisë për shkak të pajisjeve shtesë të TIK-ut dhe përdorimit të sistemeve të ftohjes dhe shuarjes së zjarrit. Duhet të konsiderohet instalimi i paneleve diellore për të siguruar energji për operimet e serverit për të reduktuar konsumin e energjisë jo të rinovueshme. Në çatinë e objektit ekzistues në Deçan mund të instalohen panele diellore të mjaftueshme që do të përdoren për themelimin e DRC-së.

Gjithashtu, procedurat dhe masat e duhura të menaxhimit të mbeturinave elektronike dhe të përdorimit efikas të burimeve janë të përfshira në këtë PMMS të përgjithshëm, si dhe janë të specifikuara në MOP. Në përgjithësi, dispozitat e MOP-së do të inkurajojnë reduktimin e gjurmës mjedisore digjitale nëpërmjet blerjes së përgjegjshme, optimizimit të shkallës së pajisjeve dhe ripërdorimit ose riciklimit të hardware-ve; promovimit të praktikave më të mira të eko-dizajnit për aplikacionet software, të dhënat dhe hardware-ët; dhe eksplorimit të mënyrave inovative se si TI-ja mund të mbështesë mjedisin.

7.3.3 Përfitimet Sociale

Projekti do të kontribuojë ndjeshëm në zhvillimin e qëndrueshëm duke përmirësuar efikasitetin e sektorit publik dhe ofrimin e shërbimeve publike nëpërmjet përdorimit të mjeteve digjitale. Ai pritet të sjellë përfitime të rëndësishme ekonomike dhe sociale duke mbështetur investimet në infrastrukturën digjitale rezistente ndaj klimës dhe duke mobilizuar investimet për të rritur aksesin e përdoruesve në shërbimet e zgjedhura administrative dhe cilësinë e shërbimeve. Aktivitetet e projektit gjithashtu do të përmirësojnë ndërveprimin e tyre me qeverinë, gjë që do të kishte ndikim pozitiv për të gjithë qytetarët e Kosovës. Digjitalizimi gjithashtu pritet të kontribuojë në arritjen e prioritetëve të Qeverisë lidhur me gjininë.

Përfitimet sociale që pritet të rriten përmes Projektit të Qeverisjes Digjitale të Kosovës për Ofrimin e Shërbimeve përfshijnë:

- *Reduktimin e kohës për qytetarët dhe bizneset që aksesojnë shërbimet e qeverisë* falë aksesit në një numër në rritje të shërbimeve elektronike dhe aksesit digjital në arkivat dhe regjistrat fizikë të mëparshëm
- *Akses në nënshkrimin elektronik dhe vulën digjitale të legalizuar, dhe përmirësim i cilësisë dhe aksesit të përdoruesve* në shërbimet administrative nëpërmjet zgjidhjeve teknologjike duke promovuar një qasje të përqendruar të përdoruesit, duke u fokusuar fillimisht në disa shërbime të lidhura me ngjarjet e jetës dhe të dyja këto do të jenë (i) më të njohura për përdoruesit, dhe (ii) për nga perspektiva administrative, janë më pak komplekse, me përfshirje të kufizuar të palëve të ndryshme të interesit
- *Ulje të kostove administrative për Qeverinë* falë thjeshtimit administrativ, ri-inxhinierisë së procesit dhe përparësi të tjera që përshpejtojnë përdorimin e reduktuar të letrës si rezultat i digjitalizimit.

- *Racionalizimin e investimeve të TIK-ut dhe kursimet* e krijuara nga përmirësimet në ndërveprimin e sistemeve kryesore të qeverisë (p.sh., Sistemet e Informacionit të Menaxhimit Financiar (SIMF), Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SMBNJ), lista e pagave) dhe miratimi i shërbimeve të përbashkëta cloud që janë shoqëruar me përfitime financiare në kontekste të tjera
- *Zvogëlimin e humbjeve nga mashtrimi dhe korrupsioni* pasi hapësira për diskrecion zvogëlohet nga digjitalizimi i ofrimit të shërbimeve dhe funksionet e forcuara për reagimet e përdoruesve përmes inovacioneve të reja CivicTech mbështesin rritjen e përgjegjshmërisë; dhe ofrimin e mundësive për transparencë dhe llogaridhënie më të madhe
- *Aksesin e zgjeruar në shërbime për qytetarët, duke përfshirë grupet e cenushme dhe adresimin e hendekut gjinor* duke angazhuar mjete të synuara CivicTech si dhe një qasje të ofrimit të shumë kanaleve për të rritur ndërgjegjësimin, për të rritur aftësitë digjitale dhe për të përmirësuar aksesin ndaj shërbimeve publike digjitale
- *Rritjet në karrierë të njerëzve që përfitojnë nga mundësitë për të forcuar aftësitë e tyre digjitale dhe rritjen e inovacionit digjital ndër të tjera.*
- *Përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike* duke sjellë ofrimin e më shumë shërbimeve administrative online, forcimin e DRC-së dhe kalimin në infrastrukturën cloud që përfaqësojnë mundësi të rëndësishme për të forcuar rezistencën ndaj fatkeqësive duke forcuar infrastrukturën bazë për ofrimin e shërbimeve

7.3.4 Rreziqet Sociale

Pabarazia në aksesin e shërbimeve digjitale

Megjithëse dizajni i projektit garanton se shërbimet digjitale synojnë veçanërisht përmirësimin e aksesit për grupet vulnerabël dhe përfshin instrumenta të synuara CivicTech, po ashtu edhe qasje në ofrimin e shërbimeve nëpërmjet disa kanaleve për të rritur ndërgjegjësimin, për të rritur aftësitë digjitale dhe për të përmirësuar aksesin ndaj shërbimeve publike digjitale më të nevojshme për grupet vulnerabël, ekziston ende një mundësi e ulët për disa grupe/individë për të shprehur shqetësime në lidhje me pabarazinë në akses dhe përfitimet nga ndërhyrjet e përmirësuar të shërbimeve TIK në kuadër të Projektit. Këta grupe/individë mund të kenë mangësi në aftësitë e TIK-ut, janë analfabetë, u mungojnë burimet, përballen me sfida për të aksesuar shërbimet dhe përfshijnë; të moshuarit me qasje ose aftësi të kufizuara në TI, popullsinë analfabete ose me shkrim e këndim të kufizuar⁴³, komunitetet Rome, Ashkali dhe Egjiptiane, PAK, personat që jetojnë nën kufirin e varfërisë dhe njerëzit që jetojnë në zonat rurale/periferike me qasje të kufizuara në rrjetin me brez të gjerë (broadband)/TI. Rreziku vlerësohet si i ulët duke marrë parasysh: ndërhyrjet e propozuara nga Projekti dhe gjithashtu për shkak të niveleve të larta të penetrimit të internetit në Kosovë⁴⁴; qasjes në nivel të lartë të banorëve të Kosovës në mjetet e TIK-ut (përdorimi i telefonave inteligjentë është gjithashtu i lartë) dhe popullatës në moshë shumë të re në Kosovë⁴⁵. Projekti do të monitorojë dhe përmirësojë ndikimin e shpërndarjes të programit të IEK-së për të përcaktuar nëse kërkohet mbështetje shtesë për të siguruar përfitime për grupe të tilla (Romët, të moshuarit me akses ose aftësi të kufizuara në TI, të varfërit etj.).

Humbja e të dhënave dhe/ose keqpërdorimi i të dhënave

Megjithëse Projekti parashikon një nënkomponent për Menaxhimin e të Dhënave, asnjë nga aktivitetet në kuadër të Projektit nuk parashikon përpunim të drejtpërdrejtë të të dhënave, por vetëm zhvillimin e metodologjive, procedurave dhe udhëzimeve për mbledhjen, ruajtjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave; dhe

⁴³ Shkalla e analfabetizimit të popullsisë së moshës 10 vjeç e lart në vitin 2011 ishte 3,85%. Përqindja e popullsisë pa arsim formal që nuk ka përfunduar nivelin e arsimimit të shkrim-leximit ishte 5,7% (<https://ask.rks-gov.net/media/6118/women-and-man-2018-2019.pdf>)

⁴⁴ në vitin 2021, 96 për qind e familjeve kishin akses në internet dhe në vitin 2020, më shumë se 90 për qind e individëve të moshës 16 deri në 74 vjeç raportuan se përdornin internetin çdo ditë.

⁴⁵ me rreth 40 për qind të popullsisë që janë 24 vjeç ose më të rinj dhe vetëm 7 për qind janë më të vjetër se 65 vjeç

mbështetje për digjitalizimin e dokumentacionit të bazuar në letër të regjistrave kyç. Sidoqoftë, procesi i digjitalizimit mbart rrezikun e humbjes së të dhënave dhe/ose keqpërdorimit të të dhënave. Prandaj, sistemet e krijuara në kuadër të projektit do të përfshijnë konsideratat për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave digjitale. Për më tepër, dispozitat që do të sigurojnë rruajtjen e të dhënave personale, si dhe që të dhënat e mbledhura të përdoren vetëm për qëllimet e synuara dhe do të mbahen vetëm për kohën minimale të kërkuar, do të përcaktohen në MOP-in e projektit dhe do të menaxhohen nga dispozitat e përcaktuara në legjislacionin e qeverisë.

Rreziqet e Shëndetit dhe Sigurisë të Komunitetit/Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Rritja e sasisë së mbeturinave elektronike si rrjedhojë e akumulimit gjatë viteve mund të përbëjnë rrezik për shëndetin dhe sigurinë e komunitetit (ndikimet siç përshkruhen më sipër në nënseksionin mbi rreziqet sociale gjatë ndërtimit) nëse nuk menaxhohen siç duhet. Ekziston një rrezik potencial veçanërisht me kushtet e pasigurta të punës për popullatat e cënueshme të cilët janë të angazhuar në grumbullimin joformal të mbeturinave. Rreth 2 000 individë, zakonisht njerëzit e varfër nga komunitete të ndryshme të marginalizuara (si p.sh. komuniteti Rome) janë të angazhuar në grumbullimin informal të mbeturinave në mbarë Kosovën. Ata mbledhin materiale plastike, metale, letër dhe karton, bateri dhe MPEE, etj., dhe ua shesin kompanive të vogla dhe të mesme të licencuara, zakonisht për eksport. Me shumë mundësi, në këto aktivitete është i përfshirë edhe personeli nga shërbimet formale të grumbullimit. Gjithashtu, disa grumbullues mbetjesh hyjnë në ambientet e landfillit për të mbledhur mbetjet dhe për t'ia shitur ato tregtarëve të mbeturinave⁴⁶.

Ky PMMS përfshin dispozita të përshtatshme për menaxhimin e mbeturinave elektronike, duke përfshirë menaxhimin e venddepozitimeve që ka mundësi të përdoren nga Projekti, siç paraqitet edhe në Kapitullin **Error! Reference source not found.** që vijon më poshtë.

⁴⁶ Menaxhimi i mbetjeve komunale në vendet e Ballkanit Perëndimor — Profili i vendit, Nëntor 2021, Agjencia Evropiane e Mjedisit

8 ZBUTJA

8.1 Masat zbutëse mjedisore dhe sociale

Tabela e mëposhtme adreson ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale dhe propozon masat zbutëse dhe përgjegjësitë e zbatimit lidhur me ndikimet e projektit të vlerësuara në Kapitullin **Error! Reference source not found.**

Tabela 8-1 Masat e Propozuara Zbutëse Mjedisore dhe Sociale

Faza e Projektit	Ndikimet Mjedisore dhe Sociale	Masat Zbutëse	Kostot Vlerësuara	Përgjegjësitë e zbatimit	Monitorimi
Kushtet e Përgjithshme	Njoftimi dhe Siguria Punëtorëve	<p>a) Ofrimi i informacionit për popullatën vendase për qëllimin dhe kohën e fillimit dhe kohëzgjatjen e aktiviteteve të ndërtimit gjatë përgatitjes</p> <p>b) Inspektoriatet lokale të ndërtimit dhe mjedisit të informohen për punimet përpara fillimit të punimeve;</p> <p>c) Të gjitha lejet e nevojshme të jenë marrë para fillimit të punimeve (duke përfshirë ndërtimin dhe të tjera);</p> <p>d) Të gjithë punimet do të kryhen në mënyrë të sigurt dhe të disiplinuar;</p> <p>e) Rrobat dhe pajisjet mbrojtëse personale të punëtorëve të jenë në dispozicion në sasi të mjaftueshme dhe të vishen/përdoren gjatë gjithë kohës;</p> <p>f) Të vendosen shirita paralajmërues, barriera rrethuese dhe sinjalistika përkatëse që informon rrezikun, rregullat dhe procedurat kryesore që duhen ndjekur.</p> <p>g) Makineritë duhet të përdoren vetëm nga personel me përvojë dhe të trajnuar siç duhet, duke reduktuar kështu rrezikun e aksidenteve;</p> <p>h) Të gjithë punëtorët duhet të jenë të njohur me rreziqet nga zjarri dhe masat e mbrojtjes nga zjarri dhe duhet të jenë të trajnuar për përdorimin e fikëseve të zjarrit, hidrantëve dhe pajisjeve e tjera që përdoren për shuarjen e zjarreve</p> <p>i) Mjetet, pajisjet dhe fikëset e zjarrit duhet të jenë gjithmonë funksionale, në mënyrë që në rast nevojë të mund të përdoren shpejt dhe me efikasitet. Kutitë e ndihmës së parë duhet të jenë të disponueshme në vend dhe personeli të jetë i trajnuar për ta përdorur.</p>	Pjesë e kostos së projektimit	Kontraktori ASHI	Vizitë në terren

Faza e Projektit	Ndikimet Mjedisore dhe Sociale	Masat Zbutëse	Kostot Vlerësuara	Përgjegjësitë e zbatimit	Monitorimi
		<p>j) Procedurat për rastet e emergjencës (përfshirë derdhjet, aksidentet, etj.) të jenë të disponueshme në vendin e Projektit.</p> <p>k) Pajisjet e blera do të instalohen dhe përdoren duke respektuar të gjitha masat e sigurisë të përshkruara nga prodhuesi i pajisjeve dhe praktikat më të mira.</p>			
	Cilësia e ajrit	<p>a) Materialet e ndërtimit duhet të ruhen në vende të përshtatshme dhe të mbulohen për të minimizuar pluhurin</p> <p>b) Vendet e grumbullimit të mbeturinave të vendosen larg vijave të kullimit, rrjedhave ujore natyrore dhe vendeve të ndjeshme ndaj erozionit të tokës.</p> <p>c) Të sigurohen që të gjitha mjetet dhe makineritë e transportit të jenë të pajisura me pajisje të përshtatshme të kontrollit të shkarkimeve, të mirëmbajtura dhe të certifikuar rregullisht.</p> <p>d) Të sigurohet që të gjitha automjetet dhe makineritë përdorin karburant nga burime të licensuara (stacionet e licencuara të karburanteve) dhe karburant sic përcaktohet nga prodhuesi i makinerive dhe automjeteve.</p> <p>e) Automjetet e ndertimit nuk do të lihen ndezur në kantier ndërkohë që nuk janë në procesin e punës</p>			
Faza e Planifikimit/Projektimit	Rreziqet e shëndetit dhe sigurisë punëtorët	<ul style="list-style-type: none"> Miratoni parimet e shëndetit dhe sigurisë në projektim; Masat e shëndetit dhe sigurisë në punë të përcaktuara në MOP 	Pjesë e kostos së projektimit	Kontraktori ASHI	Konsideratat e shëndetit dhe sigurisë të përfshira në dokumentet e projektimit
	Eficienca energjisë	Të merren parasysh masat e eficiencës të energjisë në lidhje me;	Pjesë e kostos së projektimit	ASHI	Masat e eficiencës së energjisë të përfshira në

Faza e Projektit	Ndikimet Mjedisore dhe Sociale	Masat Zbutëse	Kostot Vlerësuara	Përgjegjësitë e zbatimit	Monitorimi
		<ul style="list-style-type: none"> Teknologjinë e informacionit (servera modernë me veçori që mund të kursejnë energji, por që duhet të aktivizohen) Infrastrukturën e energjisë (Teknologjitë e reja për përmirësimin e efikasitetit të përdorimit të burimeve, Sistemet UPS të jenë më efikas dhe të krijojnë më pak nxehtësi) Menaxhimin e rrymës së ajrit 			dokumentet e projektimit
	Gjenerimi i pluhurit dhe zhurmës nga punimet civile në shkallë të vogël, transporti (punëtorë dhe materiale, etj.)	<ul style="list-style-type: none"> Të njoftohen përdoruesit e godinave për punimet e ndërtimit Inspektoriatet vendore të ndërtimit dhe mjedisit të informohen për punimet përpara fillimit Të aplikohen masa për kontrollin e pluhurit kur është e nevojshme Kufizimi i orëve gjatë të cilave mund të kryhen aktivitetet e zhurmshme (punët e ndërtimit nuk do të lejohen gjatë natës, të kufizohen nga ora 7:00 deri në 19:00) 	E papërfillshme	Kontraktori ASHI	Inspektim në terren
Faza e Ndërtimit	Siguria e punëtorëve	<ul style="list-style-type: none"> Dispozitat e PMP-së të inkuorporuara në dokumentet e kontratës Të zbatohen të gjitha masat mbrojtëse për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve, të kërkuara sipas legjisllacionit të Kosovës Të sigurohet që udhëzimet e sigurisë duke përfshirë; standardet e sigurisë së energjisë elektrike për pajisjet dhe personelin; standardet e sigurisë së djegjes të harkut elektrik; kufijtë fizikë për punën në sistemet elektrike; standardet e ruajtjes nga zjarri dhe rruajtjes të mjedisit; Standardet e sistemit të shuarjes së zjarrit janë vendosur dhe zbatuar Të gjitha punimet të kryhen në mënyrë të sigurt dhe të disiplinuar; Pajisjet e blera të instalohen dhe përdoren duke respektuar të gjitha masat e sigurisë të përshkruara nga prodhuesi i pajisjeve dhe praktikata më të mira. Të mundësohen trajnime orientimi për shëndetin dhe sigurinë për të gjithë punonjësit e rinj 	Të përfshira në çmimin e kontratës	Kontraktori ASHI (NjZP-ja)	Masat e shëndetit dhe sigurisë janë zbatuar Dispozitat e PMP të inkuorporuara në dokumentet e kontratës Inspektimi në terren

Faza e Projektit	Ndikimet Mjedisore dhe Sociale	Masat Zbutëse	Kostot Vlerësuara e	Përgjegjësitë e zbatimit	Monitorimi
		<ul style="list-style-type: none"> Të identifikohen dhe sigurohen PPM-të e përshtatshme që ofrojnë mbrojtje të përshtatshme për punëtorët Identifikimi i shërbimeve që duhet të kryhen nëntokë (p.sh. energjia elektrike) përpara fillimit të punimeve Të gjitha instalimet elektrike duhet të kryhen nga personel i certifikuar Të zbatohen procedura strikte për çaktivizimin dhe kontrollin e pajisjeve elektrike përpara se të kryhet ndonjë punë mirëmbajtjeje. Nëse gjatë punimeve zbulohet material i dyshuar me përmbajtje azbesti, punimet duhet të ndalen dhe të njoftohen autoritetet përgjegjëse dhe të ndiqen kërkesat e UA 22/2015 Të mirëmbahet një Mekanizëm efikas dhe i aksesueshëm për ankesat e punëtorëve 			
	<p>Siguria dhe Shëndeti i komunitetit</p> <p>SHAS/NS</p>	<ul style="list-style-type: none"> Dispozitat e PMP-së të inkorporuara në dokumentet e kontratës së kontraktorit Të informohen në kohë përdoruesit e godinave dhe komunitetet fqinje për punët e ardhshme. Të garantohet siguria e përdoruesve të ndërtesave p.sh. të sigurohen kalime të sigurta. Të përcaktohen masat e kontrollit të trafikut nëse është e nevojshme Të sigurohet që të gjithë punëtorët e angazhuar nga Projekti të nënshkruajnë një Kod Sjelljeje Mirëmbani një mekanizëm efikas dhe të aksesueshëm të ankesave dhe sigurohuni që njerëzit në të gjitha zonat ku po zhvillohen punimet e projektit janë të vetëdijshëm për MZA-në. MZA-ja të jetë e sensibilizuar për SHAS/NS duke lejuar të gjithë të ngrenë ankesa të tilla Të gjithë punëtorët e drejtpërdrejtë dhe të kontraktuar do të informohen për Kodin e Sjelljes së Projektit të sensibilizuar për çështjet e SHAS/NS para nënshkrimit të kontratës. 	Të përfshira në çmimin e kontratës	Kontraktori ASHI (NjZP-ja)	<p>Punonjësit e projektit nënshkruajnë Kodin e Sjelljes Monitorimi i MZA-se</p> <p>Dispozitat e PMP-se të inkorporuara në dokumentet e kontratës/tenderit</p> <p>Inspektim në terren</p>

Faza e Projektit	Ndikimet Mjedisore dhe Sociale	Masat Zbutëse	Kostot e Vlerësuara	Përgjegjësitë e zbatimit	Monitorimi
	Ndotja nga rritja e sasisë së mbeturinave të ngurta për shkak të punimeve të rinovimit me ndikime në landfillet tashmë të mbingarkuara shtojnë çështjet/problemet që lidhen me ndotjen nga mbeturinat në Kosovë; gjenerimi i mbetjeve elektronike nga komponentët e tepërt të TIK-ut;	<ul style="list-style-type: none"> Të zbatohen praktikat më të mira për menaxhimin e mbetjeve siç përcaktohet në MOP Kontejnerët për çdo kategori mbetjesh të identifikuar të sigurohen në sasinë e mjaftueshme dhe të pozicionohen në mënyrën e duhur. Të identifikohen llojet e ndryshme të mbetjeve që mund të krijohen në vendet e rinovimit dhe të bëhet klasifikimi i tyre sipas Ligjit Nr. 04/L-060 (Ligji për Mbeturinat) Të gjitha mbetjet e ndërtimit (nga punimet e rinovimit) do të mblidhen dhe do të depozitohen siç duhet nga grumbulluesit e licencuar dhe në venddepozitimet e licencuara (ose impiantet e përpunimit të licencuara). Vendi i deponimit të mbeturinave do të përcaktohet me miratim me shkrim nga Komuna ose autoriteti tjetër kompetent (p.sh. MMPH). Mbetjet e rrezikshme të vendosen në vende të sigurta dhe të mbrojtura nga rrjedhja Për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme, do të kërkohen dhe ndiqen udhëzimet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Të dhënat e depozitimit të mbetjeve do të përditësohen rregullisht dhe do të mbahen si dëshmi për menaxhimin e duhur, siç është projektuar. Mbetjet elektronike nga pajisjet e vjetruara të TI-së do të mblidhen nga subjektet e licencuara dhe më pas të eksportohen për riciklim Të trajnohen punëtorët që merren me përzgjedhjen e mbeturinave elektronike dhe çmontimin e tyre në lidhje me shëndetin dhe sigurinë 	Të përfshira në çmimin e kontratës	Kontraktori ASHI (NjZP-ja)	MOP u zbatua i Menaxhimi i mbeturinave në përputhje me Ligjin Nr.04/L-060 Inspektim në terren Intervista me punëtorët
Operation	Konsumi i energjise	<ul style="list-style-type: none"> Të mundësohen trajnime ndërgjegjësimit për efikasitetin e energjisë 	Të përfshira në çmimin e kontratës	ASHI (NjZP-ja)	Trajnimi u krye
	Ndotja e ujit	<ul style="list-style-type: none"> Nuk do të ruhet një sasi e madhe karburanti në vend, përveç në sARBATORIN e karburantit të gjeneratorit Kimikatet dhe mbetjet e rrezikshme të vendosen në një vend të sigurt nga rrjedhja 	Të përfshira në çmimin e kontratës	Kontraktori ASHI (NjZP-ja)	Nuk ka magazinim të sasive të mëdha të karburantit

Faza e Projektit	Ndikimet Mjedisore dhe Sociale	Masat Zbutëse	Kostot Vlerësuara	Përgjegjësitë e zbatimit	Monitorimi
	Menaxhimi i mbetjeve elektronike	<ul style="list-style-type: none"> Mbetjet elektronike nga pajisjet e vjetruara të TI-së të grumbulluara nga subjektet e licencuara Të trajnohen punëtorët që merren me ndarjen e mbeturinave elektronike dhe largimin e tyre në lidhje me shëndetin dhe sigurinë dhe të sigurohet që të përdorin rroba të përshtatshme mbrojtëse, maska etj. 	Për tu vlerësuar	Kontraktori	Sasia e mbetjeve Ndërgjegjësimi i rritur
	Humbja ose keqpërdorimi i të dhënave, krimi kibernetik	<ul style="list-style-type: none"> Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike (SKSK) 2016-2019 dhe Ligji i ri i Kosovës Nr. 06/L-082, datë 2019 për Mbrojtjen e të dhënave Personale Të dhënat e privatësisë të mbledhura vetëm për qëllimet e synuara siç përcaktohet në MOP Mirëmbajtja e MZA-së efikase dhe të aksesueshme për palët e interesuara 		ASHI	Monitorimi i MZA-it
	Përfundimi i mundshëm i grupeve të pafavorizuara dhe vulnerabël nga shërbimet digjitale	<ul style="list-style-type: none"> Angazhimi me agjencitë qeveritare dhe OJQ-të (që mbështesin grupet e cenueshme) për të ofruar informacione rreth përdorimit të qasjes në disa kanale të eKosova-ës dhe mbështetjen e ofruar nga Qendra e Kontaktit e-Kosova dhe kërkimi i komenteve/reagimeve për përdorimin e shërbimeve digjitale dhe pengesat për t'u përdorur. Anketime në vitin e parë dhe në periudha afat mesme të projektit dhe në vijim (V4, V5) për të monitoruar dhe përmirësuar ndikimin e shpërndarjes të programit të IEK-së dhe përpjekjet e synuara të mobilizimit për të arritur veçanërisht grupet vulnerabël të identifikuar. Angazhimi i OSHC-ve për fushatën e informimit, edukimit dhe komunikimit (IEK) për të arritur veçanërisht grupet vulnerabël të identifikuar (të moshuarit, gratë, komuniteti rom egjiptian). Mirëmbajtja e mekanizmave efikas dhe të aksesueshëm të ankesave të palëve të interesuara 		ASHI/NjZP OJQ-te Agjensi te tjera qeveritare	Pengesat e grupeve vulnerabël u identifikuan Fushatat e Programit të IEK-së u zbatuan me sukses Monitorimi i MZA-së

9 ZBATIMI

Organet kryesore të mëposhtme përbëjnë marrvveshjet/rregullimet e qeverisë në kuadër të projektit;

Agjencia kryesore zbatuese e Projektit është Agjencia për Shoqërinë e Informacionit (ASHI).

NjZP-ja, e cila do të themelohet me urdhër të qeverisë nën ASHI në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe do të jetë përgjegjëse për mbikëqyrjen e menaxhimit të përditshëm të projektit, duke përfshirë përgatitjen dhe zbatimin në kohë të planeve vjetore të punës dhe buxheteve; përgatitjen, ekzekutimin dhe përditësimin e planeve të prokurimit dhe zbatimit; kryerjen e funksioneve fiduciare; dhe përgatitjen e raporteve financiare dhe të performancës, duke përfshirë raportet gjashtë mujore të progresit. Sipas rregulloreve të qeverisë, NjZP-ja do të themelohet dhe do të plotësohet me personel pas nënshkrimit të Marrëveshjes Financiare.

ASHI (nëpërmjet NjZP-së) do të ketë përgjegjësinë e përgjithshme për zbatimin e PMMS-së dhe sigurimin e përputhshmërisë së kontraktorit gjatë fazës së ndërtimit. NjZP-ja do të punësojë staf të kualifikuar dhe me përvojë, të pranueshëm për Bankën për të përmbushur role specifike operative dhe këshilluese, duke përfshirë një specialist Mjedisor dhe Social me kohë të plotë, aktivitetet e të cilit do të përfshijnë ndër të tjera, zbatimin e PAPI-t të përgatitur, monitorimin e MZA-së dhe mbikëqyrjen të kontratave të punës sipas PMP-së së përgatitur dhe zbatimin e PMMS-së të përgatitur.

Specialistët mjedisorë dhe socialë të grupit të punës së Bankës Botërore do të monitorojnë dhe raportojnë mbi zbatimin dhe rezultatet e PMMS-së.

Komiteti i Menaxhimit të Projektit (KMP-ja) i përbërë nga përfaqësim institucional nga agjenci të ndryshme përgjegjëse si për koordinimin ashtu edhe për zbatimin teknik do të jetë përgjegjës për koordinimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të zbatimit të projektit.

Elementet përkatës të këtij PMMS-je do të inkorporohen në dokumentet e tenderit për themelimin e DRC/QSHI dhe monitorimi i përputhshmërisë së zbatimit do të mbikëqyret nga ASHI (përmes NjZP-së). Nëse është e nevojshme, PMMS-ja do të përditësohet për të pasqyruar rreziqet mjedisore dhe sociale të shfaqura ose të paparashikuara.